



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Administrim Biznesi”**

**Institucioni i Arsimit të Lartë
“Kolegji Universitar Qiriazi”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof.As. Jonida Teta
2. Dr. Alba Skëndaj

Shkurt/2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar Qiriazi
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit (Fakulteti i Ekonomisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Administrim Biznesi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 46, datë 09.02.2012.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdher nr 361, dt.3.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akredituar me VBA Nr.106, datë 02.11.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë te plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip/anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12/ 4
18	Numri i studentëve:	7 studentë në dy vitet 2019-2020, 2020-2021 dhe 22 studentë të regjistruar në vitin 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është një program i miratuar nga MAS, me datë 09/02/2012. Ky program ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit, pranë Fakultetit të Ekonomisë në KUQ.


Programi është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 46, datë 09/02/2012 dhe akreditohet për herë të dytë. Programi i studimit "Master i Shkencave në Administrim Biznesi" me profile, ofrohet si gjuhë studimi në gjuhën shqipe dhe po punohet të ofrohet edhe në gjuhën angleze. Ky program studimi është në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe i përket nivelit 7 (shtatë) sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Programi ofrohet në gjuhën shqipe me kohë të plotë dhe është i organizuar në module të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit, gjithsej 120 ECTS i ndarë në dy vite akademike dhe katër semestra.

Objektivi kryesor i këtij programi është t'i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish, që i formon ata në fushën e administrim biznesit.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është Akredituar me VBA Nr.106, datë 02.11.2019. Nga depozitimi i dokumentave mbështetëse, së bashku me RVB, si dhe nga vizitat e kryera nga Grupi i RVJ, pranë KUQ, vihet re një përmirësim i këtij programi. Kryesisht ndryshimet më të mëdha kanë qënë në drejtim të *shtimit të stafit* pedagogjik me *tituj dhe grada shkencore*, që janë bërë pjesë e stafit efektiv të programit të studimit; kategorizimi e *grupimi i lëndëve sipas aktiviteteve formuese* në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, Appendix nr.1; *shtimi i disa lëndëve* të rëndësishme për formimin e studentëve të këtij program sic janë Menaxhimi i Projekteve, Menaxhimi i Cilësisë, Marketing Ndërkombëtar, Sistemet e Menaxhimit të Informacionit, etj; *alkokimi i 12 krediteve për praktikë profesionale*; *konsolidimi i procedurave të rekrutimit të stafit*; *rol i më aktiv i NJSBC*, sidomos në vlerësimin e lëndëve dhe mësimdhënies; *alokimi i një fondi 24'000 Euro për aktivitete të kërkimit shkencor që përfshin dhe stafe pedagogjike nga ky program*. Sa i *përket shtimit të fondeve të librave* në Bibliotekë, ende ka nevojë për më shumë fonde librash të 5 viteve të fundit, sidomos literaturë ndihmëse e huaj, si dhe marrja e *dëshmisë së gjuhës së huaj* në momentin e regjistrimit, vlen për tu parë nëse është zbatuar me përpikmëri nga institucioni.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; (rreth 200 fjalë)

Mbështetur në VKM nr. 109, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit. Gjithashtu, ASCAL ka përzgjedhur 2 vlerësues të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, i cili është një program i miratuar nga MAS, me datë 09/02/2012. Ky program ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit, pranë Fakultetit të Ekonomisë në KUQ.

Grupi i jashtëm i vlerësimit përbëhet si më poshtë:

1. Prof. Asoc. Jonida Teta,
2. Dr. Alba Skendaj,
3. Endra Velaj, Koordinator Teknik i ASCAL.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm i'u vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ky dokumentacion pati disa mangësi, të cilat u kërkuar të plotësohen nga ekspertët përpara se ata të shkonin për vizitë.

Ekspertët përgatitën draft raportin shoqëruar me pyetjet për pjesët që kërkonin qartësim të mëtejshëm dhe/ose verifikim të cilat u kryen gjatë vizitës në IAL. Gjatë ditëve të vizitave në IAL u kryen diskutime intensive dhe proaktive mes GVJ dhe drejtuesve, pedagogëve, anëtarëve të GVB-së, studentëve, stafit administrativ, etj. Dokumentacioni shtesë i kërkuar pas vizitës në IAL nga ekspertët, u vu në dispozicion përmes sistemit AMS të ASCAL.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit, intervistave dhe komenteve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master Shkencor në "Administrim Biznesi". Në fund do të paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Me datë **01/02/2023**, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare **Nr. 63 Prot., Datë 01/02/2023**, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS me datë **07/02/2023** dhe me shkresë zyrtare **Nr. 25 Prot., Datë 07/02/2023**. IAL falenderon GVJ dhe shprehet se nuk ka komente lidhur me Draft-Raportin e këtij programi studimi.

Në këtë mënyre, Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm merr formën e tij finale e përfundimtare.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Departamenti i Menaxhimit i Fakulteti Ekonomik në vizionin e tij për programin MSHAB synon të jetë model në vend dhe rajon në përgatitjen e studentëve në fushën e menaxhimit, të cilët të jenë një pikë referimi për bizneset dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Programi MSHAB është në kohezion të plotë me një sërë dokumentash strategjike të qeverisë shqiptare, si: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021- 2026); Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) dhe Plani Kombëtar për integrim evropian (2020-2022). Në takimin me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit, u përforcua mendimi dhe gjykimi që ky program synon investimin e duhur në kapitalin human, që do të kontribuojnë në rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovativ të sipërmarrjeve shqiptare, lidhjen universitet-industri dhe është një kontributor i rëndësishëm në garantimin e një arsimit të lartë cilësor. <i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i> <i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i> <i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi MSHAB ka synuar të bëhet një faktor kyç në disiplinën e menaxhimit dhe lidhshirë në vend dhe më gjerë. Harmonizimi i teorisë me nevojat e tregut shqiptar është bërë e mundur përmes njohurisë dhe aftësisë së stafit akademik dhe kompetencës së tyre për t’u përshtatur me rastet studimore, projektet apo mikrotezat e kompanive shqiptare dhe të ekonomisë shqiptare, duke krijuar në këtë mënyrë dhe modelin e konsoliduar të Shkollës së Biznesit në Shqipëri. <i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 6



	<p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Në takimin me Dekanin e Fakultetit dhe drejtuesen e departamentit përforcoam mendimin se programi MSHAB është në përputhje të plotë me vizionin e KUQ.</p> <p>Të bindur për avantazhet që programi dhe departamenti ofron përkundrejt programeve master të fakultetit, por dhe më gjerë, drejtuesit e KUQ dëshmuar dhe përmes një sërë statistikash që lidhen me aplikimet master, studimin e tregut të punës, etj që ky program mbetet një brand i fakultetit.</p> <p>“Shporta” e programeve master që FEUT ofron i shërben nga njëra anë formimit të profesionistëve për tregun e punës lokal dhe global, por dhe nga ana tjetër formimit të kërkuesve të rinj shkencorë dhe kjo e mundësuar nga metodologjitë e përdorura në mësimdhënie që synojnë aftësimin logjik, të menduarit kritik dhe thellimin në analizë.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të Dosjes së plotë të programit të studimit, Silabuseve të lëndëve dhe Planit Strategjik të Programit, evidentohet që programi MSHAB është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri për specialistë me aftësi menaxheriale, për të punuar në SME dhe ndërmarrjet e mëdha shqiptare, në organizatat jofitimprurëse dhe në organizatat e huaja që operojnë në Shqipëri dhe më gjerë.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik të departamentit të menaxhimit u diskutua sesi ata përcjellin njohuritë që vijnë përmes teksteve të huaja dhe realitetit shqiptar përmes rasteve studimore, projekteve, të ftuarve në auditor dhe vizitave në biznese.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të</p>	<p>Cikli i dytë i studimeve në KUQ dhe tërësia e programeve Master Profesional dhe Master i Shkencave që ofrohen në të, jep mundësinë e diferencimit në trajtimin e lëndëve dhe në thellimin e njohurive dhe të aftësive në MSH për t’i përgatitur studentët për studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve.</p>

tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	<p>Dosja e programeve dhe silabuset e lëndëve të japin mundësinë për të gjykuar se objektivat e MSHAB në formimin e studjuesve të ardhshëm, në formimin e individëve me aftësi të analizës kritike dhe të të menduarit kritik. Pedagogët gjatë takimit u shprehën se gjatë orës së mësimit kombinojnë disa elementë: libër; artikuj shkencorë, studentët formulojnë pyetje kërkimore duke harmonizuar konceptet teorike me të menduarit kritik.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2 Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Ne programin MSHAB, cilësia e studentëve që kanë ndjekur masterin në kohë është dëshmi dhe e suksesit të programit dhe të stafit akademik të departamentit.</p> <p>Dekani i Fakultetit, gjatë vizitës në institucion shprehet që në lidhje me përmbajtjen e programit në kohë kanë preferuar të jenë më konservatorë sepse modeli i zgjedhur është global, ndërkohë që studentët shqiptarë vështirësi kanë në kapërcimin e tranzicionit.</p> <p>Programi i studimit reflekton në përmbajtjen e tij, në planin mësimor dhe në mënyrën e formulimit të silabuseve të tij një sërë dokumentash si: Rregulloren e Komisionit të Kurrikulave; Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor Rregulloren e Organizimit të Programit të Studimit</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Fajja zyrtare e Web të KUQ</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në</p>	<p>Në Statutin e KUQ, neni 11 përcaktohen njësitë kryesore dhe bazë të KUQ. Departamenti i Menaxhimit është një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik. Në Rregulloren e KUQ, paraqitet Departamenti i Menaxhimit si një nga njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik.</p>

<p>përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi MSHAB funksionon në përputhje të plotë me Rregulloren e KUQ. Programi ka 120 ECTS. Afati i studimeve dhe organizimi i vitit akademik përcaktohet respektivisht nga Rregullorja e KUQ.</p> <p>Struktura e programit përmban veprimtari:</p> <ul style="list-style-type: none"> - formuese – Kategoria A - karakterizuese – Kategoria B - ndërsiplinore – Kategoria C - plotësuese – Kategoria D - përmyllëse – Kategoria E <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi i Programit MSH në Administrim Biznes është në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e KUQ, që përcaktojnë Departamentin e Menaxhimit si njësi bazë të njësisë kryesore Fakulteti Ekonomik.</p> <p>Struktura e programit është në përputhje të plotë me Rregulloren e KUQ dhe organizimi i studimeve bëhet bazuar në disa nene të Rregullores së KUQ.</p> <p>Në Rregulloren e Programit të Studimit qartësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Organizimi i programit të studimit - Neni 6; Struktura e Programit të Studimit – Neni 7; Elementët e Strukturës së Programit – Neni 8; Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimor – Neni 9; Plani mësimor - Neni 10. <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Ndonëse realiteti i biznesit shqiptar lidhet kryesisht me biznesin e vogël dhe të mesëm, tranzicioni i gjatë ka shtruar përpara tij nevojën për profesionistë në menaxhim. Sot, më shumë se kurrë, tregu i punës në Shqipëri, por dhe më gjerë është në kushtet e një kërkese agresive për burime njerëzore të mirëformuara dhe që kanë aftësi për të analizuar, menduar në mënyrë kritike, menaxhuar inovacionn në situata shumë më komplekse dhe më të paqarta se disa vite më parë.</p>

	<p>Qëllimi i formimit në këtë program studimi duket jo vetëm që është në përputhje me strategjitë kombëtare, por gjykojmë që synon të përgatisë studentët për një botë globale.</p> <p>Pedagogët gjatë takimit u shprehën se si përmes programit, gërshetimit të lokale dhe globale, përpiqen të krijojnë një strukturë programi që përgatit studentët si me aftësi menaxheriale që koha kërkon.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit ka hartuar një sërë dokumentash në përputhje me vizionin e institucionit dhe dëshirën e mirë për të ofruar një program MSH në Administrim Biznes që dhe një pikë referimi për bizneset dhe shoqërinë shqiptare e më gjerë.</p> <p>Plani Strategjik i Programit MSHAB është një dokument serioz i hartuar nga departamenti në të cilin qartësohen objektivat, vlerat dhe bëhet analiza SWOT, me qëllim të dizenjimit të rrugës për të ardhmen e programit.</p> <p>Në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit, gjejmë të formuluar objektivat formuese të programit, të cilat në thelbin e vet synojnë formimin e profesionistëve të menaxhimit në funksionet kryesore të biznesit dhe të organizatës, thellimin e njohurive të menaxhimit dhe aftësimin për kërkim shkencor, fuqizimi i të menduarit dhe analizës kritike, përqsja ndaj kreativitetit dhe inovacionit, si dhe përgatitja për një karrierë të suksesshme.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për</p>	<p>Programi MSHAB është mbështetur fillimisht në përvojën pozitive të krijuar nga KUQ. Gjatë bisedës me drejtuesit e fakultetit dhe takimit me pedagogët e departamentit, ata theksuan se bashkëpunimi me tregun e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 10

<p>programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>punës, bizneset e rëndësishme në vend shkon përtej dokumentave formalë, pjesë e dosjes së aplikimit për akreditim të programit MSHAB. Në takimin me studentët gjithashtu ata u shprehën se pedagogët e departamentit ofrojnë shpesh mundësi punësimi dhe intershipi për ta.</p> <p>Formalizimi i mëtijshëm i marrëdhënieve me biznesin konsiderohet një nga rekomandimet që vlerësuesit e jashtëm kanë për drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit, përtej dokumentave të paraqitura në dosjen e akreditimit.</p> <p><i>An. 1_21_Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MARS 'Dërgim raporti vjetor I KUQ 2020-2021'</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Kemi theksuar disa herë në këtë raport që programi i studimit MSHAB mbështetet në eksperiencë globale, natyrisht kjo përbën një avantazh, por në takimet me pedagogët dhe drejtuesit e departamentit/fakultetit ata u shprehën që përmes rasteve studimore, projekteve në skuadër, të fituarve në auditor, vizitave studimore në kompani, praktikave dhe punimeve të diplomave ata mundësojnë lidhjen e kompetencave me nevojat e tregut të punës. Gjithashtu, një pjesë e pedagogëve për shkak të ekspertizës së tyre si konsulentë në organizata dhe biznese shërbejnë si urë lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës.</p> <p>Drejtuesja e departamentit shprehet që përmes fokus grupeve me studentët e programit synojnë të kuptojnë më mirë nevojat e tyre dhe të përshtaten në punën e tyre, tregu është në lëvizje shumë dinamike dhe pedagogët e programi duhet t'i reflektojë ato.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes studentët janë punësuar në përputhje me diplomën e fituar.</p> <p>Ndërkohe në këtë dokument, por dhe në takimin me studentët kërkojnë një përjasje me proaktive të departamentit në lidhje me praktikën, punën kërkimore dhe lidhjen me TIK.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi MSHAB është hartuar dhe zbatohet në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe gjithë kornizës ligjore dhe rregullatore të MAS në këtë drejtim, ku një aspekt i rëndësishëm është mobiliteti i studentëve si brenda (transferimet) ashtu dhe jashtë vendit.</p> <p>Ka një numër të konsiderueshëm marrëveshesh për shkëmbimet studentore dhe të stafit. Në mënyrë periodike në WEB, publikohen mobilitetet ERASMUS për studentët e KUQ dhe të programit MSHAB.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 11

	<p>Gjithashtu në WEB, publikohen dhe thirrjet për mundësi punësimi, të panairit të punës, të konkurseve dhe aktiviteteve të ndryshme.</p> <p>Sugjerim për departamentin është dokumentimi dhe përfshirja në silabuse i shumë aktiviteteve që realisht pedagogët e departamentit zhvillojnë dhe krijimi i një database të departamentit, vecanërisht për lidhjet me industrinë.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi MSHAB është Masteri më tradicional që një Departament Menaxhimi ofron. Sipas drejtuesve të Fakultetit dhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, ky program është mbështetur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - aspektin ligjor dhe rregullator të MAS në përputhje me kërkesat e Procesit të Bolonjës - në shumë eksperiencë të tjera që vijnë përmes marrëdhënieve bilaterale, por dhe projekteve ndërkombëtare në të cilat KUQ dhe më specifikisht departamenti është përfshirë në kohë - bashkëpunimin me organizata lider në tregun shqiptar <p>An. 1_21_Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MARS 'Dërgim raporti vjetor I KUQ 2020-2021'</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Në Dosjen e Plotë të Programit të Studimit MSHAB, më specifikisht pjesët që lidhen me Programin dhe Planin Mësimor të tij, Praktika zë 12 kredite dhe 300 orë mësimore.</p> <p>Praktika mësimore me studentët e masterit reflekton kryesisht të njëjtën qasje dhe problematike si në IAL-të e tjera. Studentët pjesa më e madhe punojnë (në rastin e studentëve të MSHAB, mbi 80% e tyre) në këto kushte praktika zakonisht konsiderohet e zhvilluar në vendin e tij të punës që përputhet ose jo me programin e studimit.</p> <p>Për studentët që nuk punojnë, fakulteti ndërmjetëson me organizatat/bizneset. Praktika mësimore zhvillohet bazuar në silabus, ndërkohë Departamenti i Menaxhimit ka hartuar Udhëzuesin e Praktikës Mësimore. Në mbrojtjen e praktikës, studenti duhet të paraqesë tre dokumenta: relacion mbi praktikën e zhvilluar, Formularin e Vlerësimit nga pedagogu përgjegjës, Formularin e Vlerësimit nga mbikqyrësi në vendin e zhvillimit të praktikës.</p> <p>Formaliteti që shoqëron praktikën në çdo IAL është një çështje sensitive e të gjithë sistemit të arsimit të lartë, institucionet ndoshta duhet të mendojnë rrugë dhe zgjidhje në këtë drejtim.</p> <p>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</p> <p>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</p>

	<i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i>			
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	<p>Programi MSHAB ofrohet në gjuhën shqipe. Një mundësi e mirë për të organizuar module/tema të veçanta në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht është përmes pedagogëve të ftuar që vijnë në KUQ përmes marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit Erasmus KA1.</p> <p>Në programin MSHAB, silabuset e lëndëve e përmbajnë literaturën në anglisht.</p> <p>Sugjerim për Departamentin e Menaxhimit është që të nxisin më shumë studentët e MSHAB për shkëmbimet studentore në universitetet partnere me Erasmus KA1.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	<p>KUQ nuk përgatit në gjuhën angleze sillabuset, programin dhe suplementin e diplomës. Në lidhje me literaturën në gjuhë të huaj, ajo duhet ofrohet edhe në bibliotekën e fakultetit, në platform te ndryshme si JStore, e cila mund të aksesohet dhe jashtë fakultetit. Gjithashtu, pedagogët përmes platformës TEAMS ndajnë libra, artikujt dhe raste studimore në gjuhën angleze për studentët.</p> <p>Dokumentacioni si proces-verbalet, provimet, temat e diplomës dhe regjistri themeltar janë në gjuhën shqipe.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i studimit MSHAB i ofruar nga Departamenti i Menaxhimit i KUQ është mbështetur në tre shtylla kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, KUQ ka një përvojë të hershme në fushën e arsimit. Gjithashtu, duhet theksuar që në formatin që është sot MSHAB ekziston që në vitin 2012 dhe kjo është një përvojë e vyer, por gjithashtu një bazë e rëndësishme për të reflektuar mbi përditësimin e përmbajtjes së tij. - Së dyti, stafi akademik, ku Departamenti i Menaxhimit ka në përbërje të tij 12 pedagogë të brendshëm, të cilët përbejne stafin që mban

	<p>përgjegjësinë për t'u angazhuar në këtë program, 4 pedagogë të tjerë janë pjesë e departamenteve të tjera. Duhet theksuar që stafi akademik i departamentit është një nga pikat më të forta të këtij programi studimi. Në studimet MSH angazhimi i pedagogëve është në nivelin e gradës Doktor e lart.</p> <p>- Së treti, infrastruktura, ku Fakulteti Ekonomik ofron mjediset e nevojshme për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, në godina të konceptuara në mënyrë bashkëkohore dhe me mjetet e nevojshme vizuale për zhvillimin e mesimit. Gjithashtu, gjatë vizitës u evidentua rikonceptimi i hollit të KUQ dhe vendosja më pranë studentëve e Zyrave në shërbim të tyre</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi MSHAB funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e KUQ, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit MSHAB 2022. Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomisë që është njësi bazë e ofrimit të tij. Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Si nivel studimi, ky program mban numrin 7 të kornizës evropiane (dhe shqiptare) të kualifikimit. Ai përkon me klasifikimin e fushave të arsimit, sipas ISCED-F 2013, klasifikim i cili përdoret nga MASR dhe INSTAT. Ky program përfshihet në fushën 4 – Biznes, administrim dhe ligj.</p> <p>Përmbajtja e lëndëve në përbërje të programit të studimit garanton njohuri aftësi dhe kompetenca të nivelit 7 të AQF (Albanian Qualification Framework).</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Ekonomisë, si njësi bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 14

udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	<i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Programi MSHAB, për vetë përmbajtjen e lëndëve që ka menaxhohet plotësisht nga Departamenti i Menaxhimit. Në Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit paraqiten kompetencat e tij në lidhje me hapjen, riorganizimin, përshtatjen dhe mbylljen e programeve të studimit. Gjithashtu, Departamenti mban përgjegjësi për menaxhimin e përmbajtjes së lëndëve, mënyrën e zhvillimit të tyre, përmirësimin dhe përshtatjen e tyre në kohë.</p> <p>Në funksion të mbarëvajtjes së punës në administrimin e MSHAB, Departamenti në përputhje me Rregulloren e Organizimit të Programit MSHAB, përcakton koordinatoren e programit i cili është personel akademik dhe ka për detyrë ta ndjekë në përditshmëri programin e studimit, me qëllim administrimin më efikas të tij dhe përmirësimin e vazhdueshëm, përmes sugjerimeve që sjell në departament.</p> <p>Departamenti përpilon në mënyrë periodike raporte për ecurinë e punës së tij. Në Analizën Vjetore të Punës Mësimore, Kërkimore dhe Shkencore Departamentit të Menaxhimit për vitin akademik 2020-2021 gjejmë të analizuar: ngarkesën mësimore dhe një sërë sugjerimesh për përmirësimin e procesit mësimor; analizën e rezultateve të studentëve dhe të mësimdhënies, e cila vjen e detajuar sipas programeve të studimit dhe lëndëve; kërkimin shkencor me disa rubrika nga botimet, në mobilitetet, pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe lokale.</p> <p>Në veprimtarinë e Departamentit vend të vecantë zënë dhe mbledhjet dhe vendimet që merren, të cilat pasqyrohen në proces –verbalet e mbledhjeve. Në nivel Fakulteti hartohen raportet vjetore në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe të Udhëzimeve përkatëse të MAS.</p>

	<p>Ekspertët e jashtëm sugjerojnë që proces-verbalet e mbledhjeve të mund të zbardhen e të mbahen si dokumentacion i rregullt në kohë.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Ekspierienca dhe tradita që Fakulteti Ekonomik ka brenda KUQ ne shumë vite, duhet te krijoj oportunitete për bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit. Nëse do t'i referoheshim dokumentit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të KUQ, evidentohet që nuk ka shumë marrëveshjeve të fokusuara në fushat që KUQ mbulon duke mos përbërë një hapësirë shumë të frytshme për punën shkencore, projektet ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimin e këtij fakulteti.</p> <p>Gjithashtu, në Raportin vjetor të KUQ 2020-2021 vihet re që stafi i departamentit të menaxhimit nuk ka një përfshirje të konsiderueshme në mobilitete, projekte lokale dhe ndërkombëtare, në mjedisin e Arsimit të Lartë në Shqipëri.</p> <p>Departamenti i Menaxhimit duhet ta shfrytëzojnë për më shumë bashkëpunime industrinë. Duhet ndërtuar skemat formale të bashkëpunimit me industrinë dhe duhet gjetur rrugë që mundësojnë jo vetëm punësimin e studentëve dhe praktikant/interhipet e tyre, por dhe projektet e përbashkta, mbështetjen e ideve dhe stratupeve të reja, patentim, etj.</p> <p><i>An. 1_21_Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MARS 'Dërgim raporti vjetor I KUQ 2020-2021'</i></p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazi'</i></p> <p><i>An. 1_24_Projekti Erasmus+</i></p> <p><i>An. 1_8_Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_25_Lista e trajnimeve</i></p> <p><i>An. 3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja</i></p> <p><i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan</p>	<p>GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij programi studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj. KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe</p>

<p>marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>me organizata biznesi të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve.</p> <p><i>(Referenca Tabela 5)</i></p> <p>Bazuar në dokumentacion, por edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve është i mirë organizuar.</p> <p>Praktika mësimore ka nevojë të strukturohet dhe formalizohet më shumë, dhe në këtë përpjekje Departamenti ka përgatitur dhe një Udhëzues të Praktikës Mësimore.</p> <p>KUQ dhe për vitin akademik 2021-2022 ka zhvilluar një sërë aktivitetesh, ka bërë disa publikime në WEB, por mbetet shumë më tepër për t'u bërë në bashkëpunim me zvekanin përkatës për marrëdhëniet me sipërmarrjen dhe departamentin, për të konceptuar dhe ngritur një sistem funksional të bashkëpunimit industri – universitet.</p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në Planin Strategjik të Departamentit, një drejtim i rëndësishëm i punës së Departamentit do jetë lidhja me industrinë, formalizimi i marrëdhënieve për praktikat mësimore.</p> <p>Brenda Fakultetit ka disa eksperiencë pozitive në bashkëpunimin me industrinë. Këto praktika të mira do të duhet të funksionalizohen në nivel departamenti, fillimisht dhe më pas në nivel programi.</p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në Raportin Vjetor të KUQ pasqyrohen marrëveshjet e bashkëpunimit për kërkimin shkencor me universitetet e huaja, kryesisht europiane dhe për shkak të rritjes së intensitetit të bashkëpunimit në kuadër të projekteve Erasmus KA1 – të shkëmbimeve të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve dhe projekteve Erasmus + Capacity Building.</p> <p>Mundësitë që paraqiten në drejtim të projekteve dhe bashkëpunimeve sot janë shumë më të mëdha, Departamenti i Menaxhimit dhe Fakulteti Ekonomik ka kapacitet për më shumë ndërveprim dhe rezultate në këtë drejtim. Në nivel fakulteti mund të hartohet një strategji ndërkombëtarizimi.</p> <p><i>An. 1_21_Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MARS 'Dërgim raporti vjetor I KUQ 2020-2021</i></p>

	<p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazit'</i></p> <p><i>An. 1_24_Projekti Erasmus+</i></p> <p><i>An. 1_8_Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_25_Lista e trajnimeve</i></p> <p><i>An. 3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja</i></p> <p><i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Në Raportin Vjetor të KUQ një element i vecantë i trajtimit janë marrëveshjet e bashkëpunimit. Departamenti i Menaxhimit në Analizën Vjetore të Punës së tij, i kushton një trajtim të veçantë angazhimit të stafit në marrëveshjet dhe projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunimit me institucione në nivel lokal dhe kombëtar.</p> <p>Në nivel Fakulteti hartohet dhe një raport analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, nga ekspertët sugjerohet që ky raport të prodhohet çdo vit dhe të shërbejë për përmirësimin e punës së stafit të departamenteve dhe të programeve, MSHAB përfshirë.</p> <p><i>An. 1_21_Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MARS 'Dërgim raporti vjetor I KUQ 2020-2021</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Ne KUQ puna kërkimore shkencore është e ngritur në nivel Zv. Dekani dhe përbën një nga veprimtaritë serioze të këtij institucioni.</p> <p>Në Analizën Vjetore të e Punës të Departamentit për vitin 2020-2021, qartë evidentohet që stafi akademik është i angazhuar në botime në revista ndërkombëtare, pjesëmarrje në konferenca, angazhim në projekte dhe botim tekstesh.</p> <p>Natyrisht, kërkimi shkencor kërkon më shumë fonde në mbështetje të hulumtimit, botimit dhe gjenerimi i tyre varet nga politikat publike, por jo vetëm. Në kushtet që KUQ ka, mund të sugjerohet për një revistë shkencore, dhe KUQ i ka të gjitha kapacitetet njerëzore për një botim periodik.</p>

	<p><i>An. 1_21_Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MARS 'Dërgim raporti vjetor I KUQ 2020-2021'</i></p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazi'</i></p> <p><i>An. 1_24_Projekti Erasmus+</i></p> <p><i>An. 1_8_Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_25_Lista e trajnimeve</i></p> <p><i>An. 3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja</i></p> <p><i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Në KUQ, Zyra e Kërkimit Shkencor është njësi përkatese që merret me kërkimin shkencor, i cili është i lidhur ngushtë me punën për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, me rritjen e nivelit të procesit e ndërkombëtarizimit të programeve të institucionit. Niveli i kërkimit shkencor vlerësohet periodikisht si në aspektin sasior, ashtu dhe në atë cilësor.</p> <p><i>An. 3_25_Lista e trajnimeve</i></p> <p><i>An. 3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja</i></p> <p><i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave, GVJ konstatoi se institucioni ndjek një politikë të kujdeshme të promovimit të botimeve të tij, duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera. Nje tregues i promovimit të punës kërkimore shkencore te institucionit është dhe fakti se shumë botime të pedagoqeve janë prezentë në tregun rajonal, por edhe atë perëndimor.</p> <p>Promovimi më i mirë i kërkimit shkencor do të bëhej përmes angazhimit në projekte ndërkombëtare dhe projekte të industrisë në Shqipëri, kjo është një hapësirë ende për t'u elaboruar në universitet tona. Hapi i parë i promovimit të punës shkencore është krijimi brenda departamentit i një kulture të njohjes dhe diskutimit të botimeve, projekteve individuale e në grup si dhe i citimit të njëri tjetrit.</p> <p><i>An. 3_25_Lista e trajnimeve</i></p> <p><i>An. 3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja</i></p>

	<i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i>			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Ruajtja e pronësisë intelektuale realizohet nëpërmjet vleresimit objektiv të veprimtarisë botuese edhe mbi të gjitha tek stimulimi i punës së studentëve dhe ruajtja e saj. Ky fakt ka bërë që të promovohen dhe të zhvillohen të drejtat e bashkëautorësisë. Deklaratat e autorësisë në punimet e studenteve (tema e diplomës) dhe bashkëpunimet midis brezave të personelit të institucionit janë mundesi e mirë e ruajtjes së pasurisë intelektuale.			
	<i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i>			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Njohuritë bazë dhe të përdorshme që marrin studentët gjatë këtij programi studimi kanë për qëllim jo vetëm orientimin e tyre drejt tregut të punës, por dhe në iniciativat e tyre sipërmarrëse. Rritja e bashkëpunimeve me universitete e huaja për aplikime të përbashkëta, rritjen e pjesëmarrjes së pedagogëve në këto projekte dhe angazhimi gjithnjë dhe më i madh i studenteve në këtë fushë synon realizimin e këtij objekti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit përmban lëndë sipas ligjit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë - Lëndë karakterizuese - Lëndë ndërdisiplinore dhe Lëndë integruese; - Lëndë plotësuese - Detyrime përmbyllëse <p>KUQ ofron programe të studimeve të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor për programin e studimit MScAB pasqyron zhvillimin e programit në dy vite akademike, me 120 kredite, sipas përcaktimeve për programet master i shkencave në legjislacionin për arsimin e lartë. Plani përmban informacionet për lëndët/modulet të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave (gjithsej katër semestra me nga 15 javë secili).</p> <p>Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studentët përfitojnë 120 ECTS.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MScAB ofron njohuri të thelluara profesionale në fushat ekonomike të Administrimit të Biznesit. Ky profil ka si qëllim përgatitjen e drejtuesve, specialistëve apo pjesëtarëve të stafeve të kompanive private, të institucioneve shtetërore apo organizatave jofitimprurëse me një orientim të caktuar.</p> <p>Përfundimi me sukses i këtij programi studimi u mundëson studentëve rritjen e shanseve për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale apo akademike shkencore.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura</p>	<p>Në programin e studimit MScAB jepen njohuri të thelluara nga fushat e menaxhimit, marketingut, menaxhimit të shitjeve, sjelljes</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 21

<p>në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>konsumatore dhe teknologjisë së informacionit si dhe u mundëson studenteve pajisjen me dije dhe aftësi për të analizuar situata dhe për të zgjidhur probleme nëpërmjet vendimarrjeve racionale. Programi ka evidentuar për çdo specialitet elementët e nevojshëm teorikë të përdorshëm në praktikë. Kjo evidentohet në syllabuset e secilës prej lëndëve të programit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në programin e studimit MScAB përfshin module që zhvillojnë njohuritë e studentëve në fushën profesionale të menaxhimit marketingut, menaxhimit të shitjeve, sjelljes konsumatore dhe teknologjisë së informacionit. Ky program studimi ka për qëllim të pajisë me njohuri teorike dhe praktike të diplomuarit në këtë program studimi. Gjithashtu, objektivi kryesor i këtij programi është të japë njohuri mbi mekanizmat dhe marrëdhëniet financiare si edhe të pajisë studentët me aftësinë menaxheriale, si edhe me kompetenca argumentuese dhe këshilluese për institucione të ndryshme në fushën e ekonomisë. Gjithashtu, ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e administrimit të biznesit dhe sipërmarrjes.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sic është përcaktuar nga ligji, duke përcaktuar strukturën e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur, sipas viteve dhe semestrave.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas</p>	<p>Programi i studimit me profile ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndë bazë: (12 kredite) 2. Lëndë karakterizuese: (66 kredite)

kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>3. Lëndë ndërdisiplinore: (12 kredite) 4. Lëndë plotësuese: (12 kredite) 5. Detyrime përmblyese: (18 kredite)</p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i> <i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesi</i></p>			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	<p>GVJ konstaton se në planin mësimor të programit për diplomën janë parashikuar 18 kredite.</p> <p>Pesha në kredite është në përputhje me VKM nr 41.</p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i> <i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesi</i> <i>An. 3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit, i cili i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Si njësi kryesore bashkërendon veprimtarinë mësimore - shkencore në fushën e ekonomisë. Departamenti i Ekonomisë zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve mbështetet në aktet rregullative të KUQ (Statuti, Rregullorja e Organizimit të KUQ) dhe në rregulloret e njësive përkatëse, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës prej tyre. Departamenti i Menaxhimit, është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disiplina të ekonomisë, menaxhimit,



	<p>marketingut, sipërmarrjes dhe disiplina e lëndë të tjera të ndërlidhura të fushës ekonomike.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike si dhe Departamenti i Menaxhimit, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, plotësojnë dhe tejkalojnë kriterin ligjor të përbërjes sipas numrit dhe gradave. Departamenti i Ekonomisë ka në përbërjen e tij 13 punonjës efektivë, prej tyre 13 me grada dhe tituj. Departamenti angazhon aktualisht në procesin mësimor dhe të kërkimit edhe 4 punonjës me kontratë, nga të cilët tre të kategorisë profesor, duke përfituar nga ekspertiza shkencore dhe përvoja akademike e tyre.</p> <p><i>An. 3_11_ Stafit akademik qe jep mesim ne Programin e studimit AB</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Veprimtaria e Fakultetit dhe e secilit prej Departamenteve të realizohet duke u mbështetur në aktet rregullative të KUQ (Statuti, Rregullorja e Organizimit) dhe në rregulloret e njësive përkatëse, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës prej tyre.</p> <p>Departamenti i Menaxhimit, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Kjo njësi bazë programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore në disiplinat e ekonomisë, menaxhimit, marketingut, sipërmarrjes dhe disiplina e lëndë të tjera të ndërlidhura të fushës ekonomike.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në <i>An. 3_11_</i></p> <p>Departamenti në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij gjithsej 12 pedagogë, nga ku 8 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE), dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Drejtohet nga një përgjegjës që zgjidhet me zgjedhje të lira dhe ka personel të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë për ofrimin e programeve. Departamenti i Menaxhimit, ka 12 personel akademik efektiv, nga të cilët me titull akademik: 3 Profesor Doktor, 2 Profesor i Asociuar dhe 4 Doktor.</p> <p>Nga të dhënat, GVJ evidenton që stafi akademik PAE përgjegjës për këtë program studimi, është më i madh se stafi akademik PAK i angazhuar në këtë departament (8 PAE / 4 PAK).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi kërkon angazhimin e personelit për mbikqyrjen</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 24

e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	e praktikavetë studentëve. Njësitë përgjegjëse për programin FE/ DM kanë personel të mjaftueshëm që angazhohet për ndjekjen e tyre. <i>An. 3_11_ Stafit akademik që jep mesim në Programin e studimit AB</i>			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në zbatim të akteve rregullatore dhe me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë ndërdepartamentale për programet master, FE ka caktuar një koordinator si përfaqësues në zyrën master kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarinë e gjithanshme të këtyre programeve, sipas përcaktimit të detyrave të tij/saj në rregulloren FE dhe në kontratën e punës individuale.			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori i programit master angazhohet dhe bashkëpunon me njësinë bazë për të bashkërenduar shpërndarjen e ngarkesës së personelit akademik sipas lëndëve dhe programeve. Bashkë me njësinë bazë, koordinatori i programit master i propozon Dekanit të fakultetit orarin e mësimave, kalendarin e provimeve, komisionet e pranimit të studentëve dhe organizon punën për pranimin e tyre në bazë të kriterëve të shpallura. Koordinatori i programit master mbikqyr dhe raporton tek Dekani mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të diplomimit në programin MScAB. <i>An. 2_3_ Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, i cili i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Si njësi kryesore bashkërendon veprimtarinë mësimore - shkencore në fushën e ekonomisë. Departamenti i Ekonomisë zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të

<p>organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin MScAB, njësia kryesore dhe ajo bazë disponon të gjithë dokumentacionin lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ku përfshihen, statuti i KUQ, rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit, rregullorja e programit mesimor, plani strategjik për zhvillimin e programit, plani mësimor, syllabet lëndore etj.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit MScAB gjendet i pasqyruar në planin mësimor, ku përfshihen informacionet për lëndet/modulet, praktikë profesionale, diploma, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian (ECTS). Ato janë të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese përcaktuar nga aktet ligjore në fuqi (aktualisht VKM nr. 41, 24.01.2018).</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit MScAB përmban lëndë sipas ligjit: bazë -2, karakterizuese -5, ndërdisiplinore dhe integruese -3, plotësuese -1 dhe detyrime përmbyllëse -1. Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studenti përfiton 120ECTS.</p> <p>Veprimtaritë formuese të programit janë të formimit të përgjithshëm, karakterizues, ndërdisiplinore ose/dhe integruese dhe lende me zgjedhje (gjithsej 90 ECTS), praktikë profesionale (12 ECTS) dhe detyrime përmbyllëse -Teza e diplomës (18 ECTS).</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p>

	<p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit ka rregulloren e vet ku përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve në nenet 10-13.</p> <p>Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit, përfshirë rregulloren e programit të studimit MScAB dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti kriteret bazë të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe kriteret e veçanta që vendos vetë institucioni.</p> <p>Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të KUQ dhe shprehet e përmbledhur në një udhëzues të posaçëm.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për formatet e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Nga intervistat gjatë takimeve, GVJ konstatoi se programi lëndor (syllabet) diskutohen në fillim të çdo viti akademik dhe dokumentacioni firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi respekton përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore (aktualisht VKM 41/2018) dhe përfshin orë mësimore në auditor për leksione, seminare, ushtrime/ laborator, praktikë profesionale, diploma/ provimi i formimit (jo më shumë se 25 orë në javë, gjithsej 1145 orë në të dy vitet) dhe orë për punë të pavarur (jashtë auditorit) jo më pak se gjysma e fondit prej 1500 orë vjetore (1855 orë në të dy vitet). Programi është në përputhje me ligjet në fuqi.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive ka një ndërthurje dhe kombinim të lëndëve që zhvillohen në të katër semestrat, duke i përshtatur jo vetëm me njohuritë që studentët duhet të marrin për këtë program studimi por dhe me kërkesat e tregut në mënyrë që studentët të mund të fillojnë një karrierë profesionale apo akademike shkencore të suksesshme. Praktika profesionale dhe përgatitja e tezës së diplomës, me të cilën përmbyllet studimet, luajnë rol thelbësor në këtë drejtim. Kjo evidentohet në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve të programit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit është përcaktuar se shpërndarja e moduleve në semestrin e parë dhe të dytë i jep studentëve njohuri bazë në fushën e administrimit të biznesit, të nevojshme për funksionet drejtuese që ata pritet të realizojnë në vendet e tyre të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 28

<p>formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>punës. Keto njohuri ndiqen në semestrin pasardhës nga lëndë të profileve përkatëse, sipas fushave respektive si dhe permbyllet me realizimin e praktikës dhe tezën e diplomes. Vlerësimi i lëndëve në kredite e mundëson arritjen e objektivave të programit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit me të gjitha elementët që e shoqërojnë janë në përputhje me profilin e programit. Në lidhje me programet e tjera ndërkombëtare GVJ mendon se përafrimi ndërkombëtar duhet të jetë në fillim gjeografik rajonal në Ballkan dhe Europë, gjë të cilën e konfirmon në këtë rast.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese ndjek kërkesat ligjore, GVJ evidenton se raporti teori praktikë favorizon më tepër teorinë në mënyrë që të arrihen objektivat e programit por edhe në funksion të punësimit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabet e lëndëve ndjekin procesin e përditësimit çdo vit akademik, fakt i konfirmuar nga stafi i Departamentit dhe nga përgjegjësi i saj. GVJ në rishikim të dokumentacionit vëren se syllabet lëndore kanë të përditësuar literaturën e tyre sipas kërkesave ligjore në lidhje me 5 vitet e fundit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>



<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ gjykon nga përmbajtja e programeve të lëndëve se për këtë nivel studimi të ciklit të dytë se lëndët janë me tematikat dhe koncepte bazë perkatese.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Duke marrë parasysh dhe sa janë përmendur në kriteret e mësipërme, GVJ gjykon se ky program ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca të thelluara teorike dhe profesionale. Në programin e studimit MScAB formimi teorik dhe kryesisht ai praktik i studentëve bëhet në fushën e strategjive të marketingut, menaxhimit strategjik; menaxhimit të sistemeve të informacionit në fushat perkatese; lidërshipt; strategjive ne biznes; inovacionit dhe gjenerimit te aktiviteteve te reja. Ky formim mbështetet dhe ngrihet mbi njohuritë e fituara në programin e ciklit të parë. Hapja e studimeve doktorale në Shkenca Ekonomike pranë KUQ është një mundësi për thellim të studimeve dhe karrierën e tyre akademike.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i> <i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ gjykon se përmbajtja e programit e mundëson ecurinë e studentëve në studime të mëtejshme, si edhe duke u bazuar te studimi i tregut të punës një pjesë e mirë e studenteve janë punësuar, c'ka bën të vleresohet se ka një përqindje të lartë përshtatje me pritshmeritë e tregut të punës.</p> <p><i>Analiza e tregut të punës</i></p>
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Në planin mesimor të programit studimit MScAB gjenden të pasqyruara lëndë që kanë si qëllim ofrimin e njohurive, si dhe aftësimin e studentëve ne fushën e kërkimit shkencor. Konkretisht, ne lëndët Metodave të kërkimit në biznes, metoda sasiore, modelime dhe simulime në biznes studentëve u ofrohen njohuri sa i përket fazave të kërkimit shkencor, metodave të kërkimit/ modele e teknika të analizimit të të dhënave statistikore si dhe një analizë të detajuar të kërkimit sipas profileve të programit.</p>

	<i>Syllabus evidence</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi; pedagogët që mbulojnë nevojat e programit janë me titull Prof.Dr, Prof. Asoc, Dr., në fushën përkatse të mësimdhënies.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (<i>Referenca- Tabelat përmbledhëse: tabela 8</i>), ky program studimi në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij gjithsej 12 pedagogë nga ku 8 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE), dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Drejtohet nga një përgjegjës që zgjidhet me zgjedhje të lira dhe ka personel të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë për ofrimin e programeve. Departamenti i Ekonomise, ka 19 personel akademik efektiv, nga të cilët me titull akademik: 1 Profesor Doktor, 3 Profesor i Asociuar dhe 8 Doktor ndërsa 5 janë me master. Nga të dhënat, GVJ evidenton që stafi akademik PAE përgjegjës për këtë program studimi, është më i madh se stafi akademik PAK i angazhuar në këtë departament (19 PAE / 4 PAK).</p> <p><i>An. 3_13_Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim</i></p>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>GVJ konstaton se programi mbulohet me staf akademik efektiv dhe staf akademik me kontratë.</p> <p>GVJ nga të dhënat e vëna në dispozicion, evidenton një tendecë në ngritje për mbulimin e programit në përqindje nga stafi akademik efektiv. Për vitin akademik 2021-2022 mbulimi i programit përmbush raportin 75% PAE / 25 % PAK.</p> <p><i>An. 1_6_1_Formati i dosjes personale të stafit</i></p> <p><i>An. 3_13_Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim</i></p>

	<i>An. 3_12_CV-të e stafit akademik që japin mësim në programin e studimit Administrim Biznes</i>			
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në Institucion, GVJ konstatoi se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p><i>An. 1_6_1_Formati i dosjes personale të stafit</i></p> <p><i>An. 3_13_Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim</i></p> <p><i>An. 3_12_CV-të e stafit akademik që japin mësim në programin e studimit Administrim Biznes</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Sipas vizitës në institucion dhe marrëveshjeve në fuqi si dhe nga takimi me studentët, KUQ ofron mundësinë për të udhëzuar studentët në praktikën e tyre profesionale. Duke qenë se një pjesë e studentëve janë të punësuar, në pjesën më të madhe institucioni ofron mbështetje në lidhje me temën e diplomës.</p> <p>Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p><i>An. 3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	<p>KUQ ka kapacitete njerëzore dhe financiare për të garantuar mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, që janë në funksion të programeve të studimit, përfshirë edhe programin e studimit MScAB.</p> <p><i>An. 3_25_Lista e trajnimeve An. 3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja</i></p> <p><i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga takimet që GVJ pati në Institucion, ka patur rishikim të kurrikulës dhe në të janë përfshirë propozime nga aktorë nga biznesi apo aktorë të tjerë të tregut të punës. Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private i kanë mundësuar KUQ të mbajë kontakte dhe të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca, profesione dhe vende pune që krijohen dhe ndryshojnë herë pas here. Këto informacione fakulteti dhe departamenti i merr në takimet dhe aktivitetet e përbashkëta me partnerë nga tregu i punës: kompani, organizata dhe njësi të pushtetit qendror e local, ku zhvillohen praktikant, lektorë të ftuar, anëtare të bordeve të punës etj.</p> <p><i>An. 3_9_1_Plani mësimor i programit të studimit AB</i></p> <p><i>An. 3_14_Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet NJSBC, institucioni ka filluar procesin e përfshirjes së studentëve në përmirësimin e programeve. Kjo kryhet nëpërmjet pyetësoreve që Drejtorja ka hartuar dhe analizon. Gjithsesi, është akoma në fazë primare për të përcaktuar nëse reflektimi i propozimeve të studentëve në lidhje me programin e studimit është kryer për shkak të evidencave të pa mjaftueshme në lidhje me këtë.</p> <p><i>An. 3_9_1_Plani mësimor i programit të studimit AB</i></p> <p><i>An. 3_14_Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim për tregun pas diplomimit, iniciativë të cilën GVJ e konsideron shumë të vlefshme në lidhje me vendimet strategjike në lidhje me programin por edhe me koordinimin administrativ të tij.</p> <p>Paralelisht, Zyra e ALUMNI dhe Këshillimit të Karrierës e krijuar në KUQ ka ndërmarë një nisëm për gjurmimin e studentëve të diplomuar në mënyrë që të krijohet një databazë me këta studentë. GVJ njëj përpjekjen e institucionit për të përmbushur këtë kriter.</p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit</p>	<p>KUQ ka kapacitete didaktike, infrastrukurore dhe menaxheriale që ti përgjigjet kërkesave dhe nevojave për programe specifike që mund</p>

vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	të vijnë nga institucionet publike e private në nivel qendror e lokal, në fushat e ekspertizës që mbulon edhe ky program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit MScAB, janë në përputhje të plotë me drejtimit që institucioni ofron programet e studimit, me fushën e ekspertizës së personelit akademik të FE dhe me gjithë veprimtarinë kërkimore të njësisë që e ofron atë. Misioni dhe objektivat e programit të studimit MScAB janë të përshtatur me misionin e përgjithshëm të institucionit dhe shprehin qartë filozofinë e tij. <i>An. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit AB</i> <i>An. 3_14_Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Ekonomisë vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave ekonomike. Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit. <i>An. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit AB</i> <i>An. 3_14_Syllabuset e lëndëve</i> <i>An. 1_8_Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i> <i>An. 3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit AB</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon	Programi i studimit MScAB është rezultat i bashkëpunimit me universitete europiane dhe rajonale dhe zbatimit të politikave studimore dhe shkencore europiane. KUQ është aktivisht e

studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të punonjësve të tij që kryesisht lidhet me mobilitetin e stafit akademik, shpërndarjen e informacioneve shkencore, mbështetjen për pjesëmarrje në konferenca e seminare kombëtare dhe rajonale, si dhe përfshirjen në studime konkrete. Kjo bën që dhe studentët të jenë pjesë aktive e këtyre aktiviteteve.			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	<p>Programi i studimit MScAB është rezultat i bashkëpunimit me universitete europiane dhe rajonale dhe zbatimit të politikave studimore dhe shkencore europiane. Kjo pasi KUQ është aktivisht e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të punonjësve të tij që kryesisht lidhet me mobilitetin e stafit akademik, shpërndarjen e informacioneve shkencore, mbështetjen për pjesëmarrje në konferenca e seminare kombëtare dhe rajonale, si dhe përfshirjen në studime konkrete.</p> <p><i>An. 1_8 Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_19 Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit AB</i></p>			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	<p>Me fokus ngritjen profesionale të personelit akademik, institucioni mbështet pjesëmarrjen në keto aktivitete. KUQ inkurajon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet financimit të teksteve universitare dhe të tjera, financimit për botime artikujsh dhe konferencash si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave ndërkombëtare nga KUQ pa pagesë. Në nivel institucional kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet alokimit vjetor për kërkimin shkencor i cili inkurajon hulumtimin dhe publikimin në revista prestigjoze.</p> <p><i>An. 1_8 Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_19 Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit AB</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.8

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 35

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Fushat themelore të kërkimit shkencor janë parashikuar në strategjinë e kërkimit shkencor dhe kanë si bazë Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor. Ato janë fokusuar në specialitetet që ka vetë KUQ dhe që janë ato të fushës ekonomike dhe menaxheriale. KUQ mundëson një mjedis motivues të kërkimit shkencor për personelin akademik dhe studentët, duke krijuar grupe pune dhe fusha kërkimore, si dhe nëpërmjet zyrës së projekteve bashkëpunon me institucione partnere në projekte shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>An. 1_8_Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit AB</i></p>								
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Strategjia e zhvillimit e KUQ është proaktive, konkurruese dhe në partneritet me komunitetin duke ofruar shërbime në fushat respektive të ekspertizës. KUQ inkurajon dhe angazhon stafin akademik në veprimtari kërkimore shkencore dhe projekte dhe analiza studimore me impakt komunitetin. Tematika e diplomave të propozuara për studentët e programit MScAB dëshmon këtë orientim dhe angazhim të departamentit.</p>								
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Informacionet shkencore në Departament janë një traditë në FE, ku gjatë prezantimeve të ndryshme që bëhen nga personeli akademik, ftohen të marrin pjesë edhe studentët për të qenë sa më pranë të rejave më të fundit të pedagogëve të tyre. Gjatë periudhave të ndryshme dhe sipas kontekstit, gjatë viteve të fundit, në auditoret e KUQ janë mbajtur leksione të hapura për studentët dhe webinarë të ndryshme.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Përgjatë vizitës në ambjentet e KUQ, bazuar dhe në RVB të vënë në dispozicion, GVJ identifikoi që në programin e studimit Master Shkencor në 'Administrim Biznes', mësimdhënia zhvillohet me metoda inovatore ku përdoret teknologjia e informacionit. Ky program studimi përdor format e mësimdhënies dhe transferimit të dijeve si: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime/laborator, praktikë dhe diplomë. Për të dhënë mësimin në mënyrë sa më inovatore dhe me metodat më të reja të fushës personeli akademik është trajnuar. Gjithashtu, bazuar në metodat e reja të mësimdhënies hibride ose online, në këtë program është përdorur platforma e mësimdhënies online Google Classroom. Në këtë program studimi për të përmbushur nevojën e metodave të ndryshme dhe inovatore të mësimdhënies zhvillohen leksione të hapura dhe orë mësimore interactive të drejtuara jo vetëm nga teoria, por dhe nga aplikueshmëria praktike e tyre.</p> <p><i>An. 3_9_1_Plani mësimor i programit të studimit AB</i></p> <p><i>An. 3_14_Syllabuset e lëndëve</i></p> <p><i>An. 1_23_Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimi on-line</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p>Nuk rezulton që të perdoren vlerësime të diferencuara midis pedagogësh dhe që synojnë stimulimin dhe inkurajimin e pedagogëve që aplikojnë metoda të reja dhe bashkëkohore.</p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu, NJSBC zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjerimet e marra nga</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 37

	<p>këto grupe fokusi, NJSBC ja vë në dispozicion përgjegjësit të departamentit përkatës, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjërimeve. Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo akademik nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i> <i>An. 1_4_1 Raporti vjetor I NJSBC (2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Forma më e përdorur për këtë ka qënë organizimi i anketave dhe pyetësorëve, të cilët përpilohen në bashkëpunim me zyrën e kontrollit të cilësisë. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve, si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit.</p> <p>Sipas konstatimit të GVJ rezultatet e pyetësorëve bëheshin të ditura për departamentin nga NJSBC për cdo semestër.</p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i> <i>An. 1_4_1 Raporti vjetor I NJSBC (2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Zyra përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë që është ngritur dhe funksionon në nivel universiteti, harton raporte dhe i bën ato objekt diskutimi dhe analiza në senatin akademik. Gjithashtu, për departamentin përgjegjës për këtë program studimi janë caktuar 2 pedagogë të cilët ndjekin çështjet e cilësisë në nivel departamenti. Paralelisht njësia bazë dhe kryesore (Departamenti dhe Fakulteti) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.</p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i> <i>An. 1_4_1 Raporti vjetor I NJSBC (2020-2021)</i> <i>An. 1_5 Manuali i cilesise</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira,</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, evidentohet se Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi përdorin mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësori i studentëve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 38

nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit, sic na është konfirmuar edhe në takimet me përgjegjësen e Departamentit. Por, në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së Departamentit të Ekonomisë që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembuj të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në lëndët dhe modulet e këtij program studimi përdoren format klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet, seminarët, ushtrimet, punimet e kursit, punët e pavarura, praktikë profesionale, tema diplome. Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personal akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, në lëndë të ndryshme, stafi akademik aplikon metoda të ndryshme të zhvillimit të procesit mësimor, në funksion të natyrës dhe vecorive së çdo lënde dhe të bazës materiale të nevojshme. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve, Format e mësimit teorik e praktik janë: leksionet dhe seminarët të integruara, ushtrimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Gjithashtu, në KUQ organizohen leksione të hapura nga lektorë të ftuar. Gjithashtu, Institucioni i kushton vëmendje dhe



	<p>rëndësi organizimit të konferencës studentore. Stafit është i hapur për përmirësimin dhe pasurimin e metodave të mësimdhënies ndër vite.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Ne kuadrin e mbështetjes të procesit të mësimdhënies, stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive.</p> <p>Institucioni npm NJSBC, vazhdimisht organizon trajnime të karakterit pedagogjik dhe psikologjik për stafin akademik si dhe atë ndihmës apo administratë për mbarëvajtjen e të gjithë procesit mësimor.</p> <p><i>An. 1_5 Manuali i cilesise</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë të cilët janë ende në proces doktorature. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive. Ata kanë fituar një eksperiencë të kënaqshme, janë relativisht të rinj dhe kjo përbën një avantazh të dukshëm. Një pjesë e këtij personeli janë të angazhuar në proces mësimdhënës edhe në universitete të tjera brenda vendit dhe kjo përbën pa asnjë dyshim një avantazh të dukshëm dhe progres të evidentueshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni, kryesisht njësi bazë/Departamenti, vlerëson format e mësimdhënies dhe analizon performancën e këtij procesi. Për këtë Departamenti, si strukturë që drejton programin, analizon periodikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik; • Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor; • Realizon dhe tërheq opinionin e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies; <p>Kontrollet e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga departamenti, identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve.</p> <p><i>An. 1_5 Manuali i cilesise</i></p>

<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Personeli akademik përdor diskutime të lira dhe metoda të tjera interaktive në orët e mësimit që synojnë përfshirjen dhe gjallërimin e shprehjes së lirë të ideve dhe të inkurajimit të studentëve për të përfutuar nga ky diskutim.</p> <p>Nga vizita në institucion mësuam se personeli akademik përpaket që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimit, të përdorë case study, apo të përfshijë raste nga tregu lokal.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Programi i studimit, i nivelit master shkencor, i është larguar formës klasike së mësimdhënies. Programi ka karakter sa teorik po aq edhe praktik dhe profesional. Studentët nxiten shumë për punë të pavarur. Midis pedagogëve dhe studentëve dominon respekti i ndërsjellë dhe reciprok si dhe fryma e ndërtimit të marrëdhënieve të ngrohta dhe komunitare.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga vizita që GVJ pati në Institucion, evidentoi se godina e KUQ që përdorej edhe për këtë plan studimi, mundëson që procesi mësimor e shkencor për të gjitha programet e studimeve të zhvillohet brenda të gjithë parametrave moderne. Sipas orarit të mësimit semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione dhe seminare) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambientet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve janë të pajisur me</p>

<p>për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>kompjutera e projektorë. Godina e KUQ ku zhvillon mësimin ky program studim dhe ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 sipas të cilit kërkohen 2.5 m² / student.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukurë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>KUQ ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukurore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukurës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ iu referua se pika të forta në department mbeten logjistika IT e programet kompjuterike. Gjithashtu, sic e përmendëm edhe më sipër, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektorë.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Biblioteka ofron tituj bazë dhe materiale mbështetëse në shqip si edhe në gjuhë të huaj. Literatura gjendet në bibliotekën e KUQ në versionin fizik, me numër të konsiderueshëm titujsh dhe kopjesh, dhe në formë elektronike në formatin “Fondi i literaturës elektronike të KUQ”, të përdorshme nga i gjithë personeli akademik dhe studentët. Bibliotekat online në të cilat ka akses KUQ ofrojnë një masë shumë të madhe literature në gjuhë të huaj në dispozicion të punës më të thelluar nga personeli akademik dhe studentët në fushat e programit/ profilit të tyre. Departamenti informohet për botimet më të fundit në fushat e lidhura me programet e tij dhe planifikon shtimin e tyre në bibliotekë, në përputhje me procedurat e administrimit dhe ato financiare të institucionit.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet teksteve mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturës ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. GVJ evidentoi që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si</p>

	<p>edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo rezultoi se nuk përdorej nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin.</p> <p>Universiteti përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>KUQ ka salla konferencash dhe ambiente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Gjithashtu, në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, është edhe një laborator i teknologjisë së informacionit. Në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, KUQ ka vendosur në dispozicion të studentëve të të gjithë programeve 3 laboratorë informatike dhe 1 sallë interneti, ku mund të zhvillohen seminarët që kërkojnë përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të punohet për detyrat e kursit apo punime të tjera akademike. Ato janë të hapura gjatë gjithë ditës për studentët e KUQ.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Komunikimi i brendshëm mes stafit akademik dhe studentëve, bëhet nëpërmjet platformës Teams ose adresave të emailit.</p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi i menaxhimit të informacionit</i></p> <p><i>An. 1_23_Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimin on-line.</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Në KUQ komunikimi i brendshëm bëhet përmes faqes së internetit të tij që është platforma SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentit), ku i gjithë personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të gjithë studentët posedojnë një adresë emaili.</p> <p><i>An. 1_23_Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimin on-line.</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Studenti ka të drejtë të propozojë sipas dëshirës së tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë (ose të zgjedhë ndër temat që pedagogët udhëheqës kanë propozuar në Departament), të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 43

	Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti. Refereuar RVB, studentët zgjedhin temën e diplomës dhe pedagogun udhëheqës një muaj nga fillimi i vitit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është përgjegjëse për të siguruar cilësinë e programeve të studimit në KUQ dhe përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien.</p> <p>NJSBCZHK e zhvillon aktivitetin e vet sipas një plani kalendarik të përvitshëm. Në koordinim me fakultetet dhe departamentet programohen veprimet në njësitë apo proceset që i nënshtrohen kontrollit/ vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ neni</i></p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	<p>Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu, NJSBC zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjerimet e marra nga këto grupe fokusi, NJSBC ja vë në dispozicion përgjegjësit të departamentit përkatës, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjerimeve. Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo vit. akademik nga përgjegjësi i</p>

	<p>departamentit. Vetë Institucioni realizon pyetësor për të ditur mendimet dhe sygjerimet e stafit mësimdhënës si edhe atë ndihmës në lidhje me mësimdhënien, por jo vetëm.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ neni 26, 30</i></p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Leksionet e hapura nga lektorë të ftuar të huaj dhe vendas të organizuara në KUQ, marrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Konferenca Studentore e organizuar me mbështetjen e stafit akademik, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve, duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, zenë një vend të rëndësishëm në fokusin e aktiviteteve të KUQ me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe Departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit dhe Departamentit të Menaxhimit , kualifikohet brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes trajnimeve, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimin të stafit akademik për përmirësimin e aftësime të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimi i programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimin si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit.</p>

raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<i>An. 1_8 Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i>			
	<i>An. 3_19 Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit AB</i>			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	KUQ ka një sërë marrëveshjes dhe parteritete me Institucione të Arsimit të Lartë në vend dhe jashtë duke zhvilluar herë pas here edhe leksione të hapura. Ky angazhim ka ndihmuar në rritjen e universitetit dhe krijimin e vazhdimësisë së bashkëpunimit me institucionet partnere.			
	<i>An. 1_8 Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i>			
	<i>An. 3_19 Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së KUQ realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegiumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; - detyrave të kursit për problematikën e disiplinës; - provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës; <p>Skema e vlerësimit është e njëjtë në të gjitha lëndët. Mënyra e vlerësimit është:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Provimi i ndërmjetëm (20%) • Provimi përfundimtar (60%) • Detyrat e kursit/prezantim/punë në grup (10%) • Pjesëmarrja aktive në seminar (10%) <p>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p>								
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita ne institucion konstatuam se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës, studentët informohen rregullisht, në fillim të cdo semestri dhe përgjatë tij lidhur me lëndët, me syllabusat e cdo lënde dhe me kërkesat e programit për studentët. Ata njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këture detyrimeve. Bazuar në rregulloret e studimeve të KUQ si edhe rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Vlerësimi dhe testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme të tilla si: vlerësimi me punime të pavarura, ose detyra kursi, një kontroll ose vlerësim të pjesshëm si edhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse dhe mesatare. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_13_1 Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i></p>								
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse dhe mesatare. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_13_1 Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="600 1671 751 1742">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="751 1671 967 1742">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="967 1671 1174 1742">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1174 1671 1428 1742">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="600 1742 751 1816"></td> <td data-bbox="751 1742 967 1816"></td> <td data-bbox="967 1742 1174 1816"></td> <td data-bbox="1174 1742 1428 1816">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit; 2. Vlerësimi përfundimtar; <p>Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni si edhe nga vizita në Institucion, GVJ nuk evidentoi përdorim të ndonjë sistemi elektronik për testimin apo edhe vlerësimin. Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (sekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin.</p>
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Komisionet e provimeve përbëhen së paku nga 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është pedagogu apo lektori i lëndës dhe tjetri asistenti ose një pedagog që ka të njëjtin profil ose të përafert.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i></p>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	<p>Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (csekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback	<p>Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 48



<p>(nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit. Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Hartimi i tezave të reja bëhet për çdo sezon provimi. Personelit akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm, Studentëve nuk u lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Rezultatet e provimit i vihen në dispozicion sekretarisë mësimore brenda 7 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit, e cila njofton studentët individualisht për rezultatin. Gjatë vizitës së GVJ në Institucion, në takimin që pati me sekretarinë mësimore evidentoi se brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, studenti ka të drejtë të shohë provimin e korrigjuar apo të bëjë ankimum në rast se ka pretendime për rezultat më të lartë.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orëve). Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit</p>

me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore. <i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i> <i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>An. 1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i>								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili ngre një komision <i>ad hoc</i> , në përbërje të të cilit janë edhe pedagogët e komisionit të provimit. Rezultati përfundimtar pas rivlerësimit i bëhet me dije studentit nga sekretaria mësimore, brenda një jave nga depozitimi i ankesës. Ky vendim i bashkëngjitet procesverbalit të provimit. Kjo është një procedurë por që për këtë program studimi, GVJ ju bë me dije se nuk ka patur raste. <i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i> <i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>An. 1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit bankar dhe financiar si edhe vendimmarrjes së biznesit. <i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale,	Modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse, sipas ligjit.

komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i> <i>An. 3_14 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim. <i>An. 3_14 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i>
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale.	GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojnë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut. <i>An. 3_14 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik</i>
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të	Nga vizita dhe takimi me studentët, konstatoam se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 51

avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore.		
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Shpenzimet e pjesmarrjes dhe të botimit të temave të Konferencës sponsorizohen nga Institucioni. Gjithashtu, në KUQ organizohen edhe konkurse për projekte dhe ide innovative, dhe realizohen me mbështetje këshilluese nga stafi akademik.		
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi në institucion na u komunikua që nuk ka pasur raste të studentëve master të këtij programi studimi, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka Institucioni.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	KUQ ka procedura te posacme për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës. Udhëzuesi për përgatitjen e punimit të diplomës shpjegon të gjithë procesin e realizimit të zgjedhjes, hartimit dhe mbrojtjes së diplomës. Informacioni lidhur me realizimin e procesit të diplomimit iu bëhet i ditur studentëve nga njesia baze dhe nga Sekretaria Mësimore gjatë vitit akademik dhe njëkohësisht është i shpallur në faqen zyrtare të KUQ. Studentët e programit MScAB kanë detyrim akademik mbrojtjen e diplomës.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	DEK përgjegjës për programin e studimit MScAB, cakton pedagogun udheheqës (anetar i departamentit dhe ekspert i fushes) duke konsideruar kerkesen e paraqitur ne departament nga studenti qe ploteson kriteret per diplomim. Lista e fushave/ temave te diplomave dhe pedagogeve udheheqes, te miratuara nga Departamentiju vihet në dispozicion studentëve (classroom) sipas afateve te percaktuara ne kalendarin akademik të KUQ si dhe depozitohet në bibliotekën dhe sekretarinë mësimore. Departamenti programon seanca konsultimesh për studentët dhe bashkërendon punën me Bibliotekën e KUQ për sigurimin e literaturës. <i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 52

	<p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studentët e programit të studimit MScAB njihen me fushat dhe temat e sugjeruara nga departamenti për temat e diplomave sipas fushave të ekspertizës së personelit akademik, ju jepen sqarime për procesin dhe ju lihet kohë të konsultohen me pedagogët për zgjedhjen e temës. DEK angazhon personel akademik të kualifikuar me grada e tituj, eksperte të fushës për orientimin, përcaktimin dhe drejtimin e temave të diplomave për studentët.</p> <p><i>Udhëzues për përgatitjen e punimit të Diplomes</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Departamenti I menaxhimit në bashkëpunim me FE, kanë monitoruar dhe asistuar vazhdimisht studentët e programit të studimit MScAB në aftësimin e tyre për realizimin me sukses të detyrimeve të programit mësimor. Pedagogët punojnë ngushtë me studentët për aftësimin e tyre në analizën dhe gjetjen e literaturës së duhur sipas profilit dhe për vëzhgime në mjedisin e biznesit, kur nevojiten të tilla. Studentëve ju vihen në dispozicion mjediset e KUQ me qëllim mbështetjen e punës së tyre studimore.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës, janë të shprehura qartë procedurat që ndjek pedagogu udhëheqës në ndihmë të realizimit me sukses të temës së diplomës nga ana e studentit. Roli i udhëheqësit është kryesisht drejtues, këshillues dhe konsultues. Kontributi i udhëheqësit në realizimin e punimit fillon me saktësimin e temës deri në përfundimin e punimit. Udhëheqësi këshillon studentin për përcaktimin e strukturës së temës, nxjerrjen e grupçështjeve, trajtimin e problemeve teorike praktike, rekomandimin e literaturës, përcaktimin e afateve të punës, kontrollin e realizimit të detyrave si dhe formulimin e një teze të qëndrueshme.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës, janë të shprehura qartë procedurat që ndjek pedagogu udhëheqës në ndihmë të realizimit me sukses të temës së diplomës nga ana e studentit. Roli i udhëheqësit është kryesisht drejtues, këshillues dhe konsultues. Kontributi i udhëheqësit në realizimin e punimit fillon me saktësimin e temës deri në përfundimin e punimit. Udhëheqësi këshillon studentin për përcaktimin e strukturës së temës, nxjerrjen e grupçështjeve, trajtimin e problemeve teorike praktike, rekomandimin e literaturës, përcaktimin e afateve të punës, kontrollin e realizimit të detyrave si dhe formulimin e një teze të qëndrueshme.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së</p>	<p>Sipas përcaktimeve në aktet rregullatore institucionale, në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë nga juria e përbërë prej tre anëtarësh. Studentët që vlerësohen me notë kaluese në mbrojtjen e</p>

<p>diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>diplomes mbyllin ciklin e dytë të studimeve në MScAB sipas profilit respektiv.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>KUQ mundëson pajisjen me diplomë të studentëve që kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit MScAB si dhe detyrimet ndaj institucionit sipas rregullores së organizimit, kontratës së studimit dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>Studentët e MScAB me profile, në përfundim të studimeve, pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës titulluar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Master i Shkencave në Administrim Biznesi <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 3_17_Modeli I diplomes dhe suplementi I saj</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit të programit të studimit MScAB me profile, i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, bazuar në rregulloret dhe procedurat institucionale. Studenti depoziton një kërkesë pranë sekretarisë mësimore dhe brenda afateve të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë, i jepet një kopje e firmosur dhe vulosur e programit të ciklit të studimit.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Sekretaria Mësimore, nëpërmjet zyrës së saj të pranimeve, ndërton dosjen e plotë personale në format fizik dhe elektronik të studentit, që menaxhohet nga personeli i Sekretarisë Mësimore nga viti në vit. Ajo përmban të dhënat e plota për studentin deri në diplomim dhe pas mbylljes së studimeve nga ana e tij, dosja arkivohet duke respektuar legjislacionin në fuqi.</p>			
	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
--	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe në vizitën e bërë në institucion, GVJ konstatoi që institucioni mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit të angazhuar në këtë program studimi. Njësia përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit është Zyra e Burimeve njerëzore Protokoll Arkivit (ZBNJPA). Kjo zyrë mban dhe administron në formë të shkruar dhe elektronike dosjet e personelit akademik (PAK dhe PAE) dhe administrative. GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara që u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Këto dosje përmbanin dokumentat e plota të personelit, të tilla si: CV, dokumentin e identifikimit, pozicionin e punës, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore, dëshmitë e gjuhëve të huaja, dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve, kontratën e punës, etj. Gjithashtu, GVJ konstaton se informacioni për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik mbahet nga Departamenti i Manaxhimit, departamenti përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p><i>An. 1_6_Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivit, neni 4</i></p> <p><i>An. 1_6_1_Formati i dosjes personale të stafit</i></p> <p><i>An. 3_13_Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim</i></p> <p><i>An. 3_12_CV-të e stafit akademik që japin mësim në programin e studimit Administrim Biznes</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUQ i harton dhe zbaton procedurat e rekrutimit të personelit akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe mbështetur në dokumentat e brendshme të institucionit: Statutin e KUQ neni 26 dhe 30, dhe rregulloren e KUQ. Në këto procedura bëhen publike kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit. Këto kritere për programin e studimit Master Shkencor në Administrim Biznes vendosen nga departamenti i Manaxhimit dhe përcillen në Fakultetin Ekonomik. Në bazë të kërkesës që Departamenti ka për staf akademik për programin e studimit dhe miratimit nga Fakulteti, vendet shpallen në faqen e internetit të KUQ. Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision ad-hoc i përbërë nga përfaqësues të rektoratit, fakultetit dhe departamentit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 56

	<p>Procedurat për shpalljen e vendeve vakante, kriteret e përzgjedhjes dhe rekrutimin e personelit ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkivit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me këto procedura nëpërmjet përfaqësuesit të zyrës së Burimeve Njerëzore si dhe në takimin me personelin dhe drejtuesit e institucionit, dhe konstatoi se këto procedura janë transparente.</p> <p><i>An. 1.1 Statuti i KUQ neni 26, 30</i></p> <p><i>An. 1.2 Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1.6 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivit, neni 4</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>KUQ i zhvillon procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve për personel akademik në përputhje me Statutin e KUQ dhe Rregulloret e tij. Për të gjitha përzgjedhjet dhe rekrutimet e stafit ngrihen komision ad-hoc të përbërë nga antarë të rektoratit, dekanatit dhe njësisë përgjegjëse ku kërkohet punësimi i stafit. E gjithë procedura është transparente dhe bëhet publike në faqen e Webit të KUQ.</p> <p>Gjatë vizitës në ambjentet e KUQ, pikërisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivës GVJ u njoh me procedurat dhe konstatoi ndjekjen rigoroze të tyre.</p> <p><i>An. 1.1 Statuti i KUQ neni 26, 30</i></p> <p><i>An. 1.2 Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1.6 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivit, neni 4</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Kriteret për programin e studimit Master Shkencor në Administrim Biznes vendosen nga departamenti i Manaxhimit dhe përcillen në Fakultetin Ekonomik. Në bazë të kërkesës që Departamenti ka për staf akademik për programin e studimit dhe miratimit nga Fakulteti, vendet shpallen në faqen internetit të KUQ. Kriteret e vendosura për vlerësim të kandidatëve, njësia bazë i vendos bazuar në kualifikimin e nevojshëm që lidhet me natyrën, strukturën, modulet dhe programin e studimit ku kërkohet stafi. Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve më pas, bëhet nga një komision ad-hoc i përbërë nga përfaqësues të rektoratit, fakultetit dhe departamentit. Ky komision vlerësimi mbështetet për vlerësimin e kandidatëve në kriteret e përcaktuara më parë nga njësia bazë e programit të studimit. Procedurat për shpalljen e vendeve vakante, kriteret e</p>

	<p>përzgjedhjes dhe rekrutimin e personelit ndiqen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkivit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me këto procedura nëpërmjet përfaqësuesit të zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivës si dhe në takimin me personelin dhe drejtuesit e institucionit, dhe konstatoi se këto procedura janë transparente.</p> <p><i>An. 1.1 Statuti i KUQ neni 26, 30</i></p> <p><i>An. 1.2 Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1.6 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivit, neni 4</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Përgjatë vizitës në Universitetin KUQ, u njohëm me mjediset dhe kushtet e punës për personelin akademik dhe administrativ. Godina ku zhvillohen aktivitetet mësimore bazuar në dokumentacion, ka qënë institucion arsimor që në ndërtimin e saj në 1922. Kjo godinë ku zhvillohen aktivitetet mësimore të këtij programi studimi, MSHAB, është një godinë tre katëshe e cila ka një infrastrukturë të përshtatshme dhe funksionale, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Infrastruktura ofron hapsirat e nevojshme për stafin akademik sikurse, ka kushte shumë të mira pune dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave profesionale të personelit të KUQ. Mjediset kanë ndricim natyral i cili mundësohet nga dritaret që janë të vendosura në të gjitha sallat ku zhvillohet mësimdhënia, sikurse dhe në ambjentet ku qëndron stafi akademik dhe administrativ. Të gjitha mjediset që lidhen me procesin mësimor janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit (kompjuterat, projektorë, printera, skanera, etj.) si dhe mbulohen nga rrjeti wireless që ofron Internet për stafin dhe studentët. Institucioni ka gjithashtu dhe hapësira shlodhje dhe sportive në ambjentet e jashtme të tij të cilat janë në dispozicion të stafit akademik dhe të studentëve.


	<p><i>An. 1_14_Raport Vlerësimi (Relacion mbi ambientet mësimore të KUQ)</i></p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Përgjatë takimit që GVJ zhvilloi në institucion me stafin akademik përgjegjës për këtë program studimi, u informuam se KUQ ofron angazhimin e tij për ti dhënë mundësi pedagogëve të kenë një kualifikim dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm. Institucioni mbështet pjesëmarrjen e personelit në projektet kërkimore dhe mobilitetet e mundësuar prej ERASMUS+, si një mënyrë efektive për njohjen dhe përmirësimin e aftësive kërkimore dhe metodave të mësimdhënies. Në universitetin KUQ është krijuar një traditë e mirë organizimi i lektoriumeve me pedagogë vendas dhe të huaj lidhur me tema të ndryshme në të ndryshme që janë pjesë përbërëse të këtij programi studimi.</p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazi'</i></p> <p><i>An. 1_24_Projekti Erasmus+</i></p> <p><i>An. 1_8_Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_25_Lista e trajnimeve</i></p> <p><i>An. 3_31_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja</i></p> <p><i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga takimet që GVJ zhvilloi me stafin akademik të këtij programi studimi në KUQ rezultoi se mbështetja e institucionit me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimin me metodat inovative, ka përmirësuar ndjeshëm mësimdhënien, nëpërmjet eksperiencave në universitete të ndryshme europiane, por edhe brenda vendit. Të gjitha sallat ku realizohet procesi mësimor janë të kompletuara me të gjitha mjetet e nevojshme, me kompjuter, videoprojektor, me tabela te cilësisë sa larte, etj. Gjithashtu, laboratorët janë të pajisur me kompjutera të lidhura me rrjetin Lan dhe Wireless. E gjithë godina në të gjithë sallat që ajo ka është e pajisur me rrjetin e internetit, i cili mund të aksesohet nga të gjithë.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_8_Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vendit</i></p> <p><i>An. 3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit AB</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Bazuar në informacionet e marra gjatë vizitës si dhe tek dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se Fakulteti i Ekonomisë si dhe Departamenti i Manaxhimit, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit MSHAB, dëshmojnë një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin (VKM 418, Maj 2017) dhe nivelin e kualifikimit të stafit.</p> <p>Gjatë vitit 2020 – 2021 për realizimin e programit të studimit MSHAB janë angazhuar 8 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE) dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK), por nuk ka asnjë personel ndihmës akademik. Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë: - 7 pedagogë me titullin Prof. Dr. dhe Prof. Asoc. Dr. – dhe 5 pedagogë me titullin Dr.</p> <p>Personeli akademik efektiv mbulon mbi 70% të programit MSHAB dhe personeli akademik me kontratë më pak se 30% të tij, duke qënë në këtë mënyrë konfort ligjeve në fuqi.</p> <p><i>An._3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e mësimin në AB</i></p> <p><i>An._3_13_Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim</i></p> <p><i>An._3_12_CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit në AB</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ pas vizitës që zhvilloi në institucion dhe bazuar në dokumentacionet e vëna në dispozicion si RVB, konkludon që KUQ zotëron hapësirat e mjaftueshme e të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në VKM Nr. 418, dt. 10.05.2017.</p> <p>Bazuar në dokumentacion dhe në numrin e studentëve që KUQ ka, cdo student ka në dispozicion 7.8m² hapësirë të disponueshme dhe stafi ka një hapësirë prej 9.6m² në dispozicion. Të gjitha hapësirat e</p>



	<p>institucionit ishin të ndricuara, dhe të përshtatshme për të zhvilluar procesin mësimor.</p> <p><i>An. 1_14_Raport vlerësimi (Relacion mbi ambientet mësimore të KUQ)</i></p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ referuar vizitës në institucion sikurse dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatoi që KUQ ka mjedise të paisura me teknologji informacioni të cilat ndihmojnë në zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të paisura me kompjutera, videoprojektor, sisteme audio dhe lidhje interneti wireless falas për studentë dhe stafin që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Të gjitha sallat kanë kushte të mira, janë të paisura me WhiteBoard dhe rrjeti internetit shtrihet në të gjithë godinën. Studentët dhe stafi kanë akses të plotë në sisteme që mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, dhe i shërbejnë realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e internetit të KUQ</i></p> <p><i>An. 1_27_Fletëpalosje e Kolegjit Universitar 'Qirjazi'</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të zhvillimit sa më mirë të programit të studimit Master Shkencor në Administrim Biznes, KUQ ka vënë në dispozicion Laboratorin e Ekonomisë së Aplikuar për këtë program studimi. GVJ në vizitën e zhvilluar në institucion konstatoi që ky laborator i vënë në dispozicion për programin MSHAB, ishte rinovuar në vitin 2021. Kompjuterat në këtë laborator ishin të rinj dhe ishin të pajisur me programe të përshtatshme sipas lëndëve në programin mësimor. Laboratori mundëson zhvillimin e procesit mësimor bazuar në teknologjitë dhe teknikat më bashkëkohore të mësimnxënies dhe mësimdhënies.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>KUQ ka vënë në dispozicion të këtij programi mësimor dy laboratorë. Laboratori i parë është ai i Teknologjisë së informacionit i cili është i pajisur me kompjutera të cilat kanë të instaluar programe profesionale të cilat ndihmojnë dhe aftësojnë studentët që dijet teorike ti praktikojnë dhe në format më praktike. Ky laborator është në dispozicion të</p>



	<p>studentëve të këtij programi studimi jo vetëm përgjatë orarit mësimor, por dhe pas përfundimit të tij, në mënyrë që studentët të mund të zhvillojnë detyrat e kursit dhe projektet e tyre. Gjithashtu, në këtë program studimi, KUQ ka vënë në dispozicion dhe laboratorin e Ekonomisë së Aplikuar. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se ky laborator ishte i pajisur me kompjutera të cilat kishin të instaluar programe që kanë vlerë për lëmdët e zhvilluara në programin MSHAB të tilla si: Financa 5, Matlab, Eview, Solver, Data Analysis etj</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit (<i>Lista e marrëveshjeve në kuadër të programeve të FE</i>) si dhe nga informacioni që GVJ mori në takimin në institucion me titullarët e programit MSHAB, konstatojmë që KUQ ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione, firma dhe biznese private, të cilat mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi. Në bazë të programit mësimor një pjesë e praktikës duhet të zhvillohet në ambientet e KUQ, dhe institucioni vë në dispozicion të studentëve labororet, bibliotekën dhe auditorët e saj.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ.</i></p> <p><i>An. 3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit AB</i></p> <p><i>An. 1_19_Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Në përmbushje</th> <th>Përmbushje pjesërisht</th> <th>Përmbushje kryesisht</th> <th>Përmbushje plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Në përmbushje	Përmbushje pjesërisht	Përmbushje kryesisht	Përmbushje plotësisht				X
Në përmbushje	Përmbushje pjesërisht	Përmbushje kryesisht	Përmbushje plotësisht						
			X						

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret


Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit

GVJ vizitoi Bibliotekën e KUQ, të vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional. Biblioteka ishte lehtësisht e aksesueshme nga stafi dhe studentët dhe vihej në


<p>në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>dispozicion të tyre pa pagesë. Përgjatë orarit 08:00-17:00 biblioteka mund të shfrytëzohej nga të gjithë studentët e këtij programi studimi. Të gjithë studentët mundësi të barabarta në përdorimin e saj, paradite ose mbasdite, dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo prenotimeve të studentëve.</p> <p><i>An. 1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB biblioteka ka tekste mësimore të akademikëve të institucionit dhe akademikë nga institucione të tjera të cilat mbulojnë rreth 98% të lëndëve të programeve të studimit. Biblioteka gjithashtu përmbante literaturë fizike si libra, revista shkencore dhe botime periodike në gjuhën shqipe dhe të huaj të cilat janë pjesë e programeve mësimore që KUQ ka. Gjithashtu, biblioteka kishte literaturë në formën e CD-ve dhe DVD-ve në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Megjithatë GVJ mendon se pavarësisht se institucioni ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, në përbushje të rekomandimeve të lëna në akreditimin e parë të këtij programi studimi, përsëri ka vend për shtimin e titujve të librave në literaturën fizike apo online. Gjithashtu, është e nevojshme që të përditësohet literatura me botime të pesë viteve të fundit.</p> <p><i>An. 1_11_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës, si dhe mbështetur tek dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ konstaton se ka një numër të kufizuar mundësish, përsa i përket numrit të tyre, për të aksesuar bibliotekat online. Biblioteka ka vetëm 15 vende studimi dhe katër kompjutera në dispozicion ku mund të aksesohet literature online. Biblioteka online aksesohet vetëm nga kompjuterat e vendosur në bibliotekë dhe vetëm me anë të llogarisë (account) personal që student ka.</p> <p>Aksesimi online është pa pagesë, por GVJ konstaton se numri i kompjuterave që ofrojnë aksesin është i vogël dhe sugjeron shtimin e kompjuterave në bibliotekë për ti shërbyer sa më mirë navigimit të studentëve në burimet online të literaturës.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e KUQ është e pajisur me poste leximi dhe studimi sikurse dhe me kompjutera, por numri i tyre është i kufizuar. Shfrytëzimi i bibliotekës dhe kompjuterave brenda saj që sigurojnë aksesin e bibliotekës online janë të kufizuara në orarin 8:00-17:00. Për arsye mësimore në dispozicion të studentëve janë vendosur dhe dy printera që përdoren për qëllime mësimore.</p> <p>GVJ konstatoi që numri i kompjuterave është i ulët dhe sugjeron shtimin e numrit të kompjuterave në ambjentin e bibliotekës.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të RVB dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua që njësitë bazë hartojnë lista dhe kërkesat për titujt e rinj bazuar në programet e tyre mësimore. Edhe pse vitet e fundit janë bërë përmirësime në shtimin e titujve në bibliotekë GVJ konstaton nevojën e plotësimit të bibliotekës me tituj të pesë viteve të fundit.</p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar 'Qiriazi'</i></p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p> <p><i>An. 3_22_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Bazuar tek informacioni i marrë gjatë vizitës në bibliotekën e KUQ, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve nga ora 8.00 paradite deri në orën 17.00 të mbrëmjes.</p> <p>GVJ gjykon që një fashë e tillë orare edhe mund të zgjerohet, për të mos çenuar oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Përsa i përket hapësirave fizike që ofron biblioteka, GVJ sugjeron shtimin e këtyre hapësirave për ti dhënë mundësi një numri më të madh studentësh të aksesojnë burimet e saj në të njëjtën kohë.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se të dhënat dhe informacionet në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre regjistrohen dhe arkivohen nga një sistem i brendshëm i menaxhimit institucional (SMI). Sekretaria ka gjithë informacionin për ecurinë e studentëve nga regjistrimi i tyre deri në diplomimin e tyre si në formën elektronike ashtu dhe në hard-copy. GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme disa emra të studentëve të këtij programi studimi dhe konstatoi që të gjithë të dhënat e tyre në dosje, notat në regjistër dhe procesverbale, numrat e matrikullimit, etj, ishin pasqyruar korrekt. Megjithatë te dosja e një prej studentëve të regjistruar në MSHAB mungonte dëshmia e gjuhës së huaj. Gjithashtu, prania e një sistemi elektornik të menaxhimit të të dhënave të studentëve do e lehtësonte punën e Sekretarisë Mësimore dhe do të ishte më cilësor, duke shmangur dhe gabime të mundshme njerëzore.</p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi informatik dhe metodat e mësimdhënies</i></p> <p><i>An. 1_7_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale e KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar, ashtu sikurse e kemi përmenduar edhe në Standardin IV.1, zyra e Burimeve Njerëzore Protokollit dhe Arkivit, është përgjegjëse për mbedhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të KUQ. Kjo zyrë i mban të dhënat e personelit në dosje personale në format të printuar. Dosjet e personelit përditsohen periodikisht dhe në to gjenden këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> - CV e personelit (për personelin akademik, CV shoqërohet me fotokopje të artikujve dhe botimeve shkencore); - Fotokopje e pasaportës / ID dhe adresa e banimit; - Formular vetëdeklarimi / dëshmi penalteti; - Pozicioni i punës; - Diplomat;

	<p>- Gradat shkencore / titujt akademikë;</p> <p>- Libreza shëndetsore;</p> <p>- Kualifikime të tjera / informacione shtesë.</p> <p>KUQ ishte në process implementimi të një programi manaxhimi online LMS (Learning management system). GVJ konstatoi se duhet përshpejtuar implementimi i këtij sistemi pasi do të ndihmonte në përmirësimin e manaxhimit të programeve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi edhe dy dosje pedagogësh të kategorisë PAE dhe PAK.</p> <p><i>An. 1_6_Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivit, neni 4</i></p> <p><i>An. 1_6_1_Formati i dosjes personale të stafit</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit i organizuar në nivel Kolegji, Njësi kryesore dhe department, krijon akses për personelin dhe studentët në të gjitha programet e studimit. Studentët dhe pedagogët në mënyrë të personalizuar bazuar në llogaritë personale mund të marrin informacionin që i duhet në kohë reale për programin e studimit. Të dhënat gjenden njëkohësisht dhe në faqen e internetit të institucionit. Një tjetër mënyrë e shpërndarjes e informacionit, sidomos atij që lidhet me studentët bëhet publik dhe në stendat e kolegjit.</p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB-së, por edhe takimeve me studentët e programit si dhe stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit ‘Master shkencor në Administrim Biznes’, rezulton se në institucion, për komunikimin interaktiv të stafit akademik me studentët përdoren emaili dhe sistemi SMI, si dhe platforma të tjera. Përgjatë pandemisë në kolegji janë zhvilluar dhe përdorur platformat Google Clasroom, Meeting, Google Hangout dhe Zoom. Të gjitha këto platforma u përdorën bazuar dhe në udhëzuesit që u vendosën në dispozicion për përdorimin e tyre. Për ndjekjen e mungesave, realizimin e planeve mesimore, syllabusave, realizimin e orëve të mësimit etj, përdoret platforma SMI.</p>



	<p><i>An. 1_13_1_Sistemi i menaxhimit të informacionit</i></p> <p><i>An. 1_23_Udhëzim për përdorimin e platformave të mësimi on-line.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i përdorur për menaxhimin e informacionit, faqja e internetit sikurse dhe rrjetet sociale që kolegji përdor bëjnë të mundur aksesimin e të dhënave në kohë reale. Sistemi i informacionit dhe faqet web dhe sociale përditësohen në cdo ndryshim që kanë dhe janë të aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik dhe administrativ. Sistemi ka të pasqyruar kalendarin akademik, planin mësimor sipas programeve dhe semestrave, grupet mësimore, orarin, dhe klasat. Ndërsa studenti këtu mund të ndjekë në kohë reale materialet didaktike, frekuentimin, rezultatet dhe pedagogët pasqyrojnë syllabusin e lëndës, materialet didaktike si dhe vleresimet e pjesëshme dhe përfundimare të studentëve.</p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi i menaxhimit të informacionit</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>GVJ konstaton se webi i institucionit është funksional, ai është dy gjuhësh, shqip dhe anglisht. Në web GVJ, konstatoi të dhëna, rreth fakultetit, departamentit, programeve të studimit, syllabuseve etj. Gjithashtu, KUQ është aktiv edhe në rrjetet sociale.</p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (<i>Statuti i KUQ</i>) GVJ konstaton se KUQ harton dhe miraton buxhetin në përputhje me Statutin, Neni 10, 24, 25. Miratimi i buxhetit bëhet nga Bordi i Administrimit nën drejtimin e Kryetarit të Bordit. Përgatitja e buxhetit bëhet nga administratori në përputhje me parashikime ligjore, Statutin dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 67

<p>studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Rregulloren e KUQ. Bordi i Administrimit në bashkëpunim me Senatin kanë përgatitur planin financiar afatgjatë 2018-2025. Njësitë bazë të KUQ paraqesin kërkesat e tyre për vitin e ri akademik, pas miratimit në nivelet përkatëse këto kërkesa përcillen në departamentin e financës i cili bën unifikimin e tyre brenda buxhetit të institucionit si një njësi e vetme. Departamenti i financës ka hartuar një plan buxhetor afatshkurtër për një periudhë 2 vjecare.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ Neni 10, 24,25</i></p> <p><i>An. 1_2_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_14_1_Plani Buxhetor 2018-2025 për manaxhimin e institucionit</i></p> <p><i>An. 3_21_Plani i financimit të programit të studimit AB</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programeve të studimit përmban të gjitha zërat që përcakton standardi të tilla si financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative, bibliotekën, shpenzime për kërkim & zhvillim, etj. Konstatohet në këtë plan që shpërndarja e detajuar e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në nivel institucional dhe sipas njësive kryesore, janë bërë duke u mbështetur tek kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015. Për shërbimet utilitare si interneti e shërbime të tjera kolegji ka kontrata shërbimi për mirëfunksionimin e tij. Për plotësimin e kërkesave të departamenteve Bordi i Administrimit nxjerr vendime të vecanta për përmbushjen e kërkesave.</p> <p><i>An. 1_14_3_Plani Buxhetor i kolegjit 'Qiriazi' 2021-2022</i></p> <p><i>An. 1_16_Vendim i Bordit të Administrimit për pagesën e konferencave dhe paisjen e bibliotekës</i></p> <p><i>An. 1_16_1_Miratimi i fondit për punën shkencore viti akademik 2021-2022</i></p> <p><i>An. 3_26_Vendimi i Senatit akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar me vendim Bordi</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se institucioni kryen auditimin e përvitshëm vullnetar pasi nuk është akoma në kushtet për të realizuar një audit të jashtëm të detyruar nga ligji. Në dokumentin Në raportet financiare paraqiten të gjitha të ardhurat e gjeneruara nga institucioni sikurse në mënyrë të hollësishme të gjitha shpenzimet. Këto raporte bazuar në ligjet në fuqi dorëzohen në Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Tiranë.</p>

për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<p><i>An. 1_1 Statuti i KUQ Neni 10, 24,25</i></p> <p><i>An. 1_14_1 Plani Buxhetor 2018-2025 për manaxhimin e institucionit</i></p>			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se KUQ dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, dhe jo të detajuara për programet specifike të studimit që ofron dhe i dërgon ato dhe në MASR. Në bazë rezultateve të raportit të një viti, parashikohen ndërhyrje në buxhetin që miratohet nga bordi i administrimit për vitin pasardhës, duke plotësuar nevojat apo kërkesat që vijnë nga njësitë bazë apo njësitë kryesore.</p> <p><i>An. 1_21 Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MASR 'Dërgim raporti vjetor i KUQ 2020-2021.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<p>Referuar RVB-së konstatohet se KUQ i ka mjetet e nevojshme financiare për realizimin me sukses të procesit mësimor, se edhe në të kaluarën nuk ka pasur probleme në drejtim të mos financimit. KUQ ka siguruar qëndrueshmëri në financim dhe në të ardhmen një gjë e tillë është e garantuar nga të ardhurat e studentëve, por edhe financimi i aksionereve.</p> <p><i>An. 1_14_1 Plani Buxhetor 2018-2025 për manaxhimin e institucionit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se KUQ ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në zbatim të plotë të me LAL 18/2015 dhe me rregullat dhe statutin e institucionit. Rregulloret janë të parashtruara në statutin e kolegjit, rregulloren e Fakultetit Ekonomik dhe të departamentit të Manaxhimit të cilat janë të publikuara dhe në faqen e internetit të institucionit.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit MSHAB i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit. Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloret përkatëse dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR). Pranimi i kandidatëve në këtë program studimi bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim, ndërsa studentët fitues përzgjidhen bazuar në kriteret e përcaktuara me vendim të Senatit Akademik të KUQ.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit të dorëzuar konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë</p>

<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të përcaktuara qartë dhe të publikuara. Transparenca, aksesueshmeria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me këtë program, për kandidatët dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë për të vazhduar studimet në kete program studimi, bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit si dhe mjeteve të komunikimit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion konstatoi që KUQ harton dhe publikon kriteret të veçanta të cilat bazohen në ligjin e arsimit të lartë për pranimin në ciklin e dytë të studimeve. Në këtë program kriteret janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kenë përfunduar Ciklin e parë të studimeve në fusha të njëjta ose të përafërta, në universitete vendase dhe të huaja, ku për këto të fundit nevojitet më parë njohja dhe ekuivalentimi i tyre nga MAS. Përshtatshmëria e kandidaturave që vijnë nga fusha të përafërta do të trajtohet rast pas rasti nga një Komision ad hoc, i ngritur nga Dekani në nivel fakulteti. 2. Të përmbushin kriterin e gjuhës së huaj bazuar në LAL NR.80/2015. <p>Institucioni shpall kriteret specifike të pranimit cdo vit akademik të cilat shpallen në faqen zyrtare të KUQ dhe në ambjentet e institucionit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p> <p><i>An. 1_25_Kriteret e pranimit të transferimit të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se, kandidatët që duan të ndjekin studimet në ciklin e dytë si dhe gjithë publiku informohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike që kërkohen për tu regjistruar në këtë master. Informimi bëhet nëpërmjet faqes së internetit, rrjeteve sociale, organizimit të ditëve të</p>

<p>kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>hapura online dhe në institucion për të informuar studentët potencial. Megjithatë GVJ sugjeron që, për të siguruar sukses afatgjatë, të programit të studimit, njësitë përgjegjëse për këtë program studimi duhet të intensifikojnë komunikimin e tyre.</p> <p><i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.</i></p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e Web të KUQ</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p> <p><i>An. 1_25_Kriteret e pranimit të transferimit të studentëve</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ konstaton që KUQ informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Gjatë regjistrimit të tyre studentët marrin informacione të rëndësishme në lidhje me procesin mësimor, oraret, detyrimet akademike, provimet, etj, nëpërmjet sekretarisë mësimore. Ky informacion i përsëritet studentëve në fillimin e çdo viti të ri akademik. Gjithshu informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkruara hollësisht në dokumentat: Rregulloren e KUQ dhe Rregullore e programit të studimit.</p>



	<p><i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënive me jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.</i></p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ konstaton që KUQ informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishme studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Ky informacion bazohet në rregulloren e programit të studimit, departamentit dhe të fakultetit Ekonomik. Në rast transferimi këto procedura përfshijnë vlerësimin e dosjes së studentit nga një komision që shqyrton dosjen dhe e vlerëson atë për të ekuivalentuar kreditet në përputhje me udhëzimet ligjore dhe Rregulloren e KUQ.</p> <p>Informacioni është i disponueshëm për studentët dhe në faqen e internetit të institucionit arsimor.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p> <p><i>An. 1_25_Kriteret e pranimit të transferimit të studentëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ në bazë të dokumentacionit konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Në javën orientuese e cila organizohet në javën e parë të çdo semestri të ri të vitit akademik, prezantohen syllabuset ku titullarët e lëndëve prezantojnë tek studentët elementët e vlerësimit të tyre, peshat specifike të elementëve dhe shpërndarjen e tyre.</p> <p><i>An. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit AB</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në KUQ përcaktohen në Rregulloren e KUQ si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Në to përcaktohet që diploma në përfundim të ciklit të parë të studimeve Bachelor mbrohet me temë diplome në përputhje me kurrikulat mësimore të programeve të studimit. Studentët informohen për këtë nëpërmjet pedagogëve dhe Sekretarisë Mësimore. Informimi bëhet para se të fillojë semestri i dytë i vitit të dytë dhe zgjedhja e temës së punimit bëhet para se të fillojë periudha e praktikës profesionale. Në</p>

	<p>takimin me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se të gjithë studentët kishin marrë informacionet e nevojshme për të gjithë procesin e diplomimit të tyre. Studentët përzgjedhin vetë pedagogët udhëheqës e më pas bëhet përcaktimi i tyre nga departamenti bazuar në fushat e ekspertizës së tyre. Ndjekja e studentëve nga udhëheqësit bëhet përgjatë gjithë kohës së përgatitjes së diplomës.</p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p> <p><i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesi</i></p> <p><i>An. 3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstatoi që përpara fillimit të cdo viti akademik KUQ organizon takime të hapura për informimin e studentëve të interesuar mbi programin e MSHAB. Gjithashtu institucioni ka marrë pjesë dhe në ditët e Informimit të organizuar nga MAS, për të familjarizuar të interesuarit me programet e saj të studimit.</p> <p>Informacionet përpos ndarjes në ditët e informimit publikohen dhe në faqen zyrtare, në broshura informuese në amjentet e KUQ sikurse dhe në rrjetet sociale.</p> <p><i>An. 1_9_Rregullore e zyrës së Mardhënieve me Jashtë, Pranimit, Këshillimin për Karrierë</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e internetit të KUQ</i></p> <p><i>An. 1_27_Fletëpalosje e Kolegjit Universitar 'Qiriazi'</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X


Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe të takimit me studentët, që këta të fundit informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe programin e studimit. Që</p>

<p>kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>në regjistrimin e tyre dhe lidhjen e kontratës me ZMJPKK studnetët informohen për programin e studimit. Gjithashtu, mënyra të tjera informimi janë fletëpalosjet e KUQ dhe faqja e internetit.</p> <p><i>An. 1_9_Rregullore e zyrës së Mardhënieve me Jashtë, Pranimit, Këshillimin për Karrierë</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e internetit të KUQ</i></p> <p><i>An. 1_27_Fletëpalosje e Kolegjit Universitar 'Qiriazi'</i></p> <p><i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së.</i></p> <p><i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesi</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentëve të rinj ju shpjegohen në detaje përbërja e KUQ, struktura e tij, objektivat dhe strategjia, përbërja dhe struktura e Fakultetit të Ekonomisë, drejtuesit dhe stafi i tij, përgjegjësit e departamenteve etj. Gjithashtu bëhet edhe prezantimi me infrastrukturën, bibliotekën, laboratorët dhe kushtet në të cilat do të realizohet ky program studimi. Studentët mund të informohen edhe nëpërmjet planit mësimor për strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra të tyre. Në hollin e kolegjit afishohen plani mësimor i programit, orari i lëndëve sikurse dhe emrat e stafit akademik që do të zhvillojnë lëndët.</p> <p>Departamenti i Manaxhimit të Biznesit dhe koordinatori i programit të MSHAB vënë në dispozicion të studentëve të programit, syllabuset e lëndëve, modulet dhe mënyrën e organizimit të programit.</p> <p><i>An. 3_9_1_Plani mësimor i programit të studimit AB</i></p> <p><i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesi</i></p> <p><i>An. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni KUQ ka në strukturat e saj njësi të cilat orientojnë studentët për në tregun e punës dhe ofrojnë mbështetjen e duhur institucionale që tranzicioni nga kolegjii në tregun e punës të jetë sa më efektiv. Me anë të ZMJPKK, faqes së internetit, rrjetëve sociale dhe aktiviteteve të zhvilluara në institucion KUQ informon studentët për cdo mundësi punësimi apo intershipi. Institucionet të cilat janë partnere dhe ofrojnë mundësi punësimi për studentët e KUQ janë si private ashtu dhe shtetërore, dhe informacioni mbi mundësitë që ato ofrojnë përditësohet në faqen e internetit të KUQ.</p>

	<p><i>An. 1_9_Rregullore e zyrës së Mardhënieve me Jashtë, Pranimit, Këshillimin për Karrierë</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e internetit të KUQ</i></p> <p><i>An. 1_27_Fletëpalosje e Kolegjit Universitar 'Qirazi'</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në KUQ, studentëve u vihet në dispozicion një informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Strukturat kryesore të komunikimit janë sekretaria mësimore, ZMJPKK, departamenti, të cilat përdorin faqen web, rrjetet informatike, botimet e ndryshme, rrjetet sociale si dhe komunikimet e drejtëpërdrejta me studentët.</p> <p><i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhim Biznesi</i></p> <p><i>An. 1_14_2_Infrastruktura mësimore e KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>MSI informon në kohë reale studentët në lidhje me programin e mësimorit dhe synon koordinimin e punës të të gjithë hallkave të këtij programi studimi. Mënyra të tjera të komunikimit dhe informimit në kohë reale të studentëve në distancë janë përdorimi i adresave të emailit apo platformave të mësimorit në distancë të vëna në dispozicion nga KUQ.</p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi i menaxhimit të informacionit</i></p> <p><i>An. 1_28_Faqja zyrtare e internetit të KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>SMI, sistemi i brendshëm i menaxhimit që KUQ ka bërë të mundur administrimin e informacionit dokumentacionit dhe aktivitetit të studentëve. Gjithashtu informacioni i studentëve gjithashtu gjëndet, ruhet dhe administrohet dhe në formë fizike dhe në sekretarinë mësimore. Informacioni ruhet dhe është konfidencial dhe mund të aksesohet vetëm nëpërmjet kredencialeve të studentëve.</p> <p><i>An. 1_13_1_Sistemi i menaxhimit të informacionit</i></p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatoi se Sekretaria mësimore mban statistika për numrin e studentëve të regjistruar në program dhe numrin e studentëve të diplomuar. Të dhënat ruhen në formatin elektronik dhe në hard copy. Këto statistika mblidhen dhe përpunohen në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Udhëzimit të MAS "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore", Udhëzimit të MAS, Nr. 16, datë 08.07.2019 "Për pajisjen e institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve", si dhe udhëzime të tjera që dalin çdo vit. Të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar sipas programeve dhe viteve të studimit, kalueshmëria dhe diplomimi i studentëve janë statistika të cilat bëhen pjesë e raportit vjetor të institucionit.</p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_7_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale të KUQ</i></p> <p><i>An. 1_21_Shkresa Nr.328 dt 28.12.2020 e KUQ për MARS 'Dërgim raporti vjetor i KUQ 2020-2021'</i></p> <p><i>An. 3_29_Tabelë përmbledhëse për programin për studentët në hyrje dhe në dalje në tre vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Të dhënat statistikore, për programin e studimit Master Shkencor në administrim Biznes menaxhohen kryesisht nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar etj, bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e KUQ. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike dhe hard-copy.</p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_7_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale të KUQ</i></p> <p><i>An. 3_29_Tabelë përmbledhëse për programin për studentët në hyrje dhe në dalje në tre vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë</p>	<p>GVJ konstatoi përgjatë vizitës në institucion që institucioni disponon të dhëna në lidhje me ecurinë e studentëve gjatë viteve akademike, të cilat</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 77

zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	<p>grumbullohen dhe përpunohen nga sekretaria mësimore. Në përputhje me udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe të organeve drejtuese të KUQ, këto të dhëna shënohen në regjistrin e tërhequr nga institucioni për matrikullimin e studentëve. Në fund të çdo sezoni provimesh lektori i lëndës depoziton pranë sekretarisë së fakultetit proces verbalin me listën e studentëve dhe notat përkatëse si dhe një evidencë mbi pikët e fituara gjatë vitit në elementët e ndryshëm të kontrollit të dijeve si dhe pikët përfundimtare të marra në provim. Në bazë të këtyre të dhënave sekretaria mësimore bën pasqyrimin e notave në regjistrat e arritjeve akademike.</p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit MSHAB, ku përfshihen të dhënat personale, numri i matrikullimit, vlerësimet, notat mesatare në hyrje dhe në dalje dhe cdo informacion tjetër në lidhje me student gjenden dhe menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe pranë sekretarisë mësimore.</p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se departamentet dhe Sekretaria Mësimore hartojnë raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Këto raporte hartohen në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe në shërbim të njësive dhe drejtuesve të institucionit për të realizuar analizat vjetore. Në analizat vjetore të departamentit diskutohen dhe masat që duhen marrë për përmirësimet e treguesve cilësorë të këtij programi studimi.</p> <p><i>An. 3_3_Analizë vjetore e Departamentit të Manaxhimit</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret
Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

 Web site: www.ascal.al

Faqe 78


<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion konstatoi që KUQ ka përfshirë studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Studentët e këtij institucioni arsimor kanë përfaqësi në organet drejtuese të Kolegjit si Senati, NJSBC, në Këshillin e Etikës dhe komisionet e përhershme. Studentët përfaqësues në organet vendimmarrëse të Kolegjit shprehin mendimet e tyre në lidhje me programet mësimore, kodet dhe rregulloret, planet mësimore etj. Financimi i veprimtarive të këshillave studentor bëhet nga KUQ.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ, neni 8,9,43</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_5_Rregullore e Këshillit të Etikës</i></p> <p><i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>An. 3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>KUQ është garantues i përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik nëpërmjet përfshirjes së Këshillit Studentor në organet vendimmarrëse. Në këto përfshirje studentët mund të shprehin mendimin e tyre për çështjet e provcesit akademik duke filluar nga programi i studimit, çështjet e etikës dhe stafit akademik etj. Gjithashtu, studentët janë të përfshirë dhe në akreditim të programeve të studimit dhe institucional. Menimi i studentëve është i pasqyruar dhe në RVB.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 3_27_Aktivizimi i studentëve në mbledhjen e njësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në rregulloren e KUQ, në rregulloren e FE-së si dhe në rregulloren e programit të studimit MSHAB, është parashikuar ngarkesa akademike e studentëve për të gjitha programet e studimit si dhe për programin që po akreditohet. Programi i studimit duke u bazuar në ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, në urdhëra dhe udhëzime të ndryshme të Ministrisë së Arsimit, parashikon njohjen e studimeve të pjesshme apo të plota të kryera më pare nga studentët. Departamenti here pas here rishikon programet e studimit dhe syllabuset e lëndëve me qëllim që njohuritë ti përshtaten në mënyrë sa më të plotë me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p>

	<p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Sipas rregulloreve në fuqi të KUQ, studentët përcjellin mendimet e tyre dhe përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit apo të përmirësimit të programit të studimit. Studentët vlerësojnë programin dhe lëndët përmes një procesi vlerësimi. Gjithashtu, studentët janë pjesë e mbledhjeve të hapura të Departamentit ku mund të shprehin mendimin e tyre.</p> <p><i>An. 3_20_Pyetësorët e studentëve</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se atyre ju jepet mundësia të vlerësojnë performancën e pedagogëve në të gjitha aspektet e procesit mësimor, që nga procesi i mësimdhënies deri tek vlerësimi. Studentët njihen me rezultatet e marra gjatë semestrit përpara provimit, dhe me rezultatin e provimit pesë ditë pas zhvillimit të provimit. Ata pohuan se ju jepet e drejta të ankimojnë rezultatin e marrë të provimit, me një kërkesë me shkrim. GVJ nuk gjeti evidenca të dokumentuara të procedurës së ankimit të studentit për rezultatin e provimit dhe mënyrës së zgjidhjes.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Manaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e KUQ</i></p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, KUQ, nisur nga evidencat por edhe takimet me stafet drejtuese të departamentit, fakultetit, universitetit si dhe stafet akademike, vihet re se ekzistojnë përpjekje për ndjekjen e një politike ambicioze të kërkimit shkencor për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit të arsimit të lartë. Personeli akademik është i angazhuar në pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Ky aktivitet pasqyrohet në analizën vjetore që fakulteti realizon në mënyrë periodike çdo vit. Analiza përcakton qartësisht politikat e kërkimit shkencor, kërkimin shkencor për departament,curinë e studimeve të programit të studimit, aktivitetin shkencor dhe botues, pjesëmarrjen në konferenca shkencore etj.</p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"</i> <i>An. 2_14_Analiza vjetore e fakultetit Ekonomik 2021_2022.pdf</i> <i>An. 1_18_Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KUQ</i> <i>An. 3_30_Konferenca me IPE</i> <i>An. 1_2_Evidencë për pjesëmarrjen e stafit në projekte dhe kërkim shkencor (ezaurimi i fondit) (evidence shtese)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>KUQ ka qenë i angazhuar për të rritur mundësitë e bashkëpunimeve me institucione partnere, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim jo vetëm ndërkombëtarizimin e aktivitetit kërkimor-shkencor në nivel fakulteti/universiteti por edhe krijimi i mundësive për të përfituar nga rezultatet e projekteve me qëllim përmirësimin e procesit mësimor, kërkimor dhe infrastrukturor të fakultetit dhe universitetinë tërësi.</p> <p>Lista e partnerëve dhe bashkëpunëtorëve ka krijuar mundësi të reja të bashkëpunimit nga të cilat kanë përfituar personeli akademik, por dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"</i> <i>An. 1_18_Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KUQ</i> <i>An. 1_2_Evidencë për pjesëmarrjen e stafit në projekte dhe kërkim shkencor (ezaurimi i fondit) (evidence shtese)</i></p>

<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Fakulteti në vijimësi inkurajon studentët të marrin pjesë në konferenca shkencore ku bashkarisht prezantojnë rezultate të punës kërkimore. Grupi i punës sugjeron angazhim m w tw madh tw stafit akademik dhe pwrfshirje m w tw madhe tw studentwve, sikurse dhe pjesëmarrjen e më shumë aktivitete kërkimore shkencore, në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"</i> <i>An. 1_18_Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KUQ</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni duhet të mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të studentëve. RVJ nuk gjeti evidenca bindëse për ta vërtetuar se ka përfshirje të studentëve të këtij programi në aktivitete shkencore të mbështetura nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Në takimin me pedagogët GVJ u informua që personeli akademik inkurajon studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi që lidhen me situata hipotetike të biznesit dhe organizatave dhe të diskutojnë për zgjidhjet e tyre. Stafi akademik mundohet të ofrojë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, duke i mbështetur ata në pjesëmarrjen në studime të avancuara kërkimore konferenca, konkurse apo aktivitetet të tjera.</p> <p><i>An. 2_14_Analiza vjetore e fakultetit Ekonomik 2021_2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës</p>	<p>Stafi akademik i fakultetit është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konceptimit, shkrimit dhe analizës së punës së studentëve me mikrotezat. Pedagogët realizojnë në mënyrë periodike takime me studentët të cilët kanë në udhëheqje duke vlerësuar performancën dhe progresin e tyre. Këto takime strukturohen në përcaktimin e temës dhe strukturës së punimit, më pas në përpilimin dhe zbatimin e metodës së studimit dhe në fund analizën dhe interpretimin rezultateve. Pedagogu udhëheqës gjithashtu orienton studentin për prezantimin para komisionit të mbrojtjes</p> <p>Grupi i punës sugjeron angazhimin e FE me organizimin dhe pjesëmarrjen e më shumë aktivitete kërkimore shkencore, në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>An. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"</i> <i>An. 2_14_Analiza vjetore e fakultetit Ekonomik 2021_2022.pdf</i></p>



	<p>An. 2_14_Analiza vjetore e fakultetit Ekonomik 2021_2022.pdf</p> <p>An. 1_18_Politika e kërkimit shkencor. Puna kërkimore-shkencore tri vjeçare në KUQ</p> <p>An. 3_30_Konferenca me IPE</p> <p>An. 1_2_Evidencë për pjesëmarrjen e stafit në projekte dhe kërkim shkencor (ezaurimi i fondit) (evidence shtese)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Bashkëpunimet në nivel universiteti dhe marrëveshjet që vetë FE ka nënshkruar, kanë mundësuar ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe kërkimore të personelit akademik dhe fakultetit në tërësi. FE ka nisur të jetë aktiv në krijimin e lidhjeve për të mundësuar shkëmbimin e eksperiencave të stafit dhe studentëve.</p> <p>Grupi i punës sugjeron shtrirjen në një numër më të madh të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe bursave të shkëmbimit Erasmus + Mobility. Këto bashkëpunime priten të sjellin përmirësime të vazhdueshme në përmbajtjen e programit të studimit, i cili në përmbajtjen aktuale përputhet me mjaft programe që zhvillohen në institucione të ndryshme evropiane dhe për më tepër garanton vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>An.1_4_Lista e stafit studentëve që kanë marrë pjesë në mobilitete dhe shkëmbime Erasmus</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Konceptimi dhe ndërtimi i kurrikulës së programit të Masterit shkencor është realizuar me ambicien për të përgatitur studentë me kompetenca dhe aftësi për tu përshtatur në tregun e punës po aq sa edhe për të qenë pjesë e studimeve të mëtejshme. Në programin e studimit janë përfshirë lëndë me karakter formues, analitik dhe profesional, duke ju mundësuar studentëve marrjen e njohurive jo vetëm në aspekte të ndryshme profesionale, por edhe të kenë aftësi për të përdorur metoda dhe teknika të reja që zbatohen aktualisht në institucionet partnere. Kjo e gjitha mundëson dhe siguron vazhdimësinë e përgatitjes së studentëve për</p>

	<p>ciklin e tretë të studimeve, cka është një nga objektivat që ky program studimi ka.</p> <p>An. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit AB</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Politikat e kërkimit të Institucionit janë konceptuar për të qenë gjithëpërfshirëse dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e studiuesve të rinj. Kjo formë bashkëpunimi ka favorizuar angazhimin e personelit të ri në aktivitete kërkimore si dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në studime dhe në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p> <p>FE/KUQ, për të rritur profilin e vet ndërkombëtar paralel me aktivitetet në nivel institucional, në bashkëpunim me partnerët, do ishte mirë të ftojë edhe më shumë lektorë nga institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë</p>				
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Ndonëse institucioni mund të mos ketë një politikë integruese të caltuar për kërkuesit shkencorë të huaj, nga vizita e RVJ dhe bazuar në marrëveshjet Erasmus, në insitucion kanë ardhur kërkues të huaj që kanë mbajtur ligjerata për studentët e KUQ, ku kane marrëe pjesë studentë edhe nga MSHAB.</p> <p>Studentët të cilët angazhohen në aktivitetet e mobiliteteve dhe në aktivitete ndërkombëtare marrin më parë të gjithë informacionin e nevojshme përmes zyrës së marrëdhënieve me jashtë. Politikat e ndjekura për këto studentë janë të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë për konvertimin e lëndëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Studentët të cilët angazhohen në aktivitetet e mobiliteteve dhe në aktivitete ndërkombëtare marrin më parë të gjithë informacionin e nevojshme përmes zyrës së marrëdhënieve me jashtë. Politikat e ndjekura për këto studentë janë të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë për konvertimin e lëndëve.</p>				
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>FE/KUQ, për të rritur profilin e vet ndërkombëtar paralel me aktivitetet në nivel institucional, në bashkëpunim me partnerët, do ishte mirë të ftojë edhe më shumë lektorë nga institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë.</p> <p>An.1_4_Lista e stafit studentëve që kanë marrë pjesë në mobilitete dhe shkëmbime Erasmus</p>				
	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---


Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>KUQ bazuar në LAL Nr 20/2015 dhe aktet nënligjore të vetë Kolegjit ka rregullore dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të shërbimit të studentëve. Njësitë e vëna në dispozicion janë: Sekretaria Mësimore, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim e Këshillim për Karrierë dhe vetë Departamenti ku programi i studimit bën pjesë. Të gjitha njësitë kanë rregullore dhe drejtohen për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve.</p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.</i></p> <p><i>An. 3_3_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka rigrur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Njësitë që janë përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen e informacionit për studentët gjithashtu asistojnë studentin që nga regjistrimi deri në diplomim, ofrojnë informacion e këshillim për çështje të lidhura me procesin akademik dhe përfshirjen e studentëve në tregun e punës, përzgjedhjen e karrierës dhe vendin ku do të kryejnë praktikën, etj. Gjithashtu informimi i studentëve bëhet dhe nga koordinatori i programit të studimit. Mënyrat e tjera të informimit të studentëve janë dhe faja e internetit, standat në hollin e KUQ dhe fletëpalosjet.</p> <p><i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p><i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.</i></p> <p><i>An. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij</i></p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për	<p>ZMJPKK është njësia që mirëpret studentët duke ju ofruar informacione dhe orientim të posaçëm në lidhje me karrierën, praktikat profesionale, kërkesat e tregut të punës, etj. Kjo zyrë bashkëpunon me departamentet</p>

<p>këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>për organizimin e praktikave profesionale, organizon panaiet e punës, mban mardhënie me Alumni dhe i mbështet në organizimet e tyre, i ofron studentëve mundësi për bursa të ndryshme, mundësi për ndjekjen e shkollave verore, organizon workshop-e, trajnime, etj.</p> <p><i>An. 1_9 Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë.</i></p>
---	--

<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>GVJ konstatoi që Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim e Këshillim Karjere ndjek në mënyrë të vazhdueshme punësimin e studentëve të KUQ. Zyra ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe firma nga ku dhe mbledh informacionin për punësimin e studentëve dhe për të siguruar informacion në lidhje me mundësitë e punësimit të studentëve në profilet që do të mbarojnë studimet. Të gjithë të dhënat e mbledhura përpunohen në një skedë konfidenciale e më pas shfrytëzohen për gjurmimin e aktiviteteve dhe organizimeve të ndryshme përgjatë vitit akademik.</p> <p><i>An. 1_9 Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me jashtë, Pranim, Këshillim për Karrierë</i></p> <p><i>An. 1_8 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brënda dhe jashtë vendit</i></p>
---	---

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në nenin 103, të ligjit për arsimin e lartë 80/2015, është e përcaktuar se <i>“Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë”</i></p> <p>Në zbatim të këtij ligji, standardeve shtetërore të cilësisë (Kodit të cilësisë), standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG), KUQ (që në krijimin e tij) ka implementuar dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë. KUQ në konfort me standartet e ASCAL dhe legjislacionit në fuqi ka realizuar politikën e sigurimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit. Institucioni gjithashtu ka të ngritura dhe strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë të quajtura Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Për monitorimin e cilësisë KUQ ka hartuar dhe një manual, si një instrument i mirë reference dhe matjeje.</p> <p><i>An. 1_1 Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>An. 1_4_1 Raporti vjetor i NJSBC</i></p> <p><i>An. 1_4_1 Manuali i Cilësisë së KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies. Angazhimin institucional për krijimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, KUQ e ka parashikuar edhe në Planin e zhvillimit strategjik të KUQ në të cilin parashikohet përgjegjësia institucionale për konsolidimin e cilësisë dhe mekanizmat me të cilat kjo do të arrihet.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, e cila harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë dhe kodin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 87

	<p>cilësisë. Sipas rregullores dhe RVB kjo njësi përbëhet nga një student si përfaqësues i studentëve për të sjellë në vëmendje dhe problematikat që ky grup interesi ka.</p> <p><i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>An. 1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC</i></p> <p><i>An. 1_4_1_Manuali i Cilësisë së KUQ</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Në KUQ sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL. (www.ascal.al)</p> <p>Vetëvlerësimi apo vlerësimi i jashtëm institucional apo i programeve të studimit, kanë qenë pjesë e diskutimeve, e adresimit të problematikave dhe vetë rregullimit dhe në dokumentet themelore të KUQ dhe të njësive përbërëse të tij, praktikë kjo dhe për këtë raportin e vlerësimit për programin MBA. Rezultatet e arritura në kohë, tregon se KUQ dhe njësitë përbërëse, ndjekin dhe zbatojnë politika të qarta për sigurimin e cilësisë. Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron KUQ, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC dhe në aktet rregullative të institucionit.</p> <p><i>An. 1_1_Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriaz” (KUQ)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>KUQ ka hartuar politika dhe procedura për të siguruar arritjen dhe përmirësimin e cilësisë në programin e MSHAB. Në zbatim të detyrimeve që lindin në përmbushje të standardeve dhe kriterëve të sigurimit të cilësisë dhe përcaktimeve të NJSBC në nivel institucional, FE ka të përcaktuar personin përgjegjës i cili koordinon procesin e sigurimit të cilësisë në Fakultet dhe bashkërendon punën me NJSBC në nivel institucional.</p> <p>Ndërkohë, për garantimin e cilësisë në nivel fakulteti, në bashkëpunim me NJSBC janë ngritur komisione ad-hoc, të cilat kanë kryer vlerësime dhe analiza tematike. Për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, FE ka përdorur instrumentet standarde të hartuara nga NJSBC për mbledhjen e informacionit sikundër janë takimet, sondazhet dhe anketimet me studentët. NJSBC ka përgatitur një set pyetjesh sipas tematikave të cilat janë shpërndarë tek studentët për tu plotësuar në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 88

mënyrë anonime. Më pas janë analizuar të dhënat dhe është finalizuar procesi dhe komunikuar rezultatet.

Në nivel fakulteti, kryhet vlerësimi i performancës të personelit akademik në lidhje me ofrimin cilësor të programit të studimit, jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por dhe në aspektin e kërkimit shkencor, kontributit për institucionin. Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog me kohë të plotë dhe të pjesshme bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës plotësimi i të cilit bazohet në përgatitjen në kohë të syllabuseve, literaturës së përdorur, zhvillimi i leksioneve, praktikave, seminareve dhe laboratoreve, respektimi i orarit të mësimit, udhëheqjet për detyra kursi apo tema diplome. Paralelisht edhe titullarët e lëndëve plotësojnë formularët e performancës për stafin me kohë të pjesshme që ata aktivizojnë në lëndët përkatëse i cili merret parasysh në procesin e rekrutimit të tyre në vitin akademik pasardhës. Gjithashtu bëhet vlerësimi i aktivitetit shkencor të stafit pedagogjik nëpërmjet evidentimit të artikujve të botuar dhe prezantimeve orale në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përgjegjësit e departamenteve vlerësojnë gjithashtu dhe aktivitetin administrativ të pedagogëve duke vlerësuar korrektesën në kryerjen e tyre, realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve dhe të rregullores së fakultetit. Plotësimi i performancës së stafit akademik i bëhet me dije Dekanit dhe depozitohet në Dekanat. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti paraprak i cili është vënë në dispozicion të titullarit të fakultetit. Të gjithë analizat /raportet/të dhënat e dala nga procese vlerësimi janë pjesë e raporteve vjetore në nivel departamenti/fakulteti/universiteti, duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë.

An. 1_1_Statuti i KUQ

An. 1_4_Rregullore e NJSBC

An. 1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC

An. 3_5_Plani strategjik i Programit të studimit AB

An. 1_7_4_Pyetësori mbi performancën e pedagogut

An. 3_1_Plani i punës dhe realizimi i rekomandimeve të akreditimit të MSHAB

An. 1_4_Rregullore e NJSBC

	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
--	----------------------	---------------------	----------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 89

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëtit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit, është njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në MBA. Kjo njësi bashkëpunon me të gjitha strukturat përkatëse për garantimin e cilësisë së mësimdhënies dhe proceseve të tjera në funksion të programit të studimit. Koordinatori i programit të studimit (rregullore e programit) dhe drejtuesi i departamentit janë personat përgjegjës të cilët ndjekin dhe monitorojnë ecurinë e programit të studimit. Raportimet periodike, diskutimet në departamente dhe dekanat, janë pjesë e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>KUQ përveç ndjekjes së rregullore, periodikisht kryhen monitorime të procesit mësimor nga njësi kryesore dhe më pas analizohen gjetjet dhe konstatimet. Ndërkohë, në analizën vjetore të njësive bazë dhe fakultetit, ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre.</p> <p>Pjesë të kësaj analize janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmbyllur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim.</p> <p><i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 90

	<i>An. 1_8 Evidencë për notatë hyrëse dhe dalëse të studentëve</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>KUQ në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, në përfundim të çdo vitit akademik, kryhet procesi i analizë së nevojave të përditësimit të programeve në nivel institucional me qëllim rritjen e cilësisë në përmbajtje të tyre. Në përfundim të procedurave të ndjekura në funksion të përditësimit/ rishikimit apo përmirësimit të programit, iu përcillet autoriteteve vendimmarrëse për programin (përgjegjës departament/ dekanati) si dhe organeve kolegjiale (dekanati dhe senati akademik), sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi (për programin e studimit në fjale nuk ka ndryshime). Të gjitha rezultatet e mësipërme, janë pjesë e analizave vjetore të njësisë bazë dhe kryesore të KUQ.</p> <p>Departamenti dhe NJBSC-ja përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme për ecurinë e treguesve të cilësisë si, treguesit për vlerësimin e programit, treguesit për vlerësimin e lëndës, treguesit për vlerësimin e procesit mësimor dhe të pedagogut, tregues për gjendjen e infrastrukturës etj. Gjithashtu, sekretaria mësimore mban të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me arritjet e studentëve dhe të dhëna të ndryshme për to, të tilla si: arritjet e studentëve, karakteristika demografike të studentëve, vlerësimin e kërkesave të studentëve sipas shqetësimeve dhe programeve, qarkullimin e studentëve, ardhjet, largimet etj.</p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i> <i>An. 1_4_1 Raporti vjetor i NJSBC</i> <i>An. 3_5 Plani strategjik i Programit të studimit AB</i> <i>An. 1_7_4 Pyetësori mbi performancën e pedagogut</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në raportin vjetor në nivel universiteti, NJSBC, si strukturë përgjegjëse, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për institucionin.</p> <p>Ky raport është subjekt i diskutimeve në mbledhjen e organeve kolegjiale të KUQ (Senat Akademik dhe Bordi i Administrimit), ku evidentohet qartë plani i masave me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit. Pasi analizohet ky raport, dalin konkluzionet përkatëse lidhur me mënyrën e zgjidhjes së problematikave dhe përmirësimin nëpërmjet korigjimit nga ana e të gjithë aktorëve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>

	<i>An. 1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC</i>			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Referuar RVB-së dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit bazohen në krahasimin e rezultateve të pritshme me ato të vlerësimit të konstatuar si dhe në masat e marra për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Rezultatet nga raportet e vlerësimit përfshijnë tregues të performancës së pedagogëve, rezultatet e mësimnxënies, si dhe tregues të tillë si: ruajtja dhe rritja e nivelit të regjistrimeve, nivelet e kalueshmërisë, nivelet e diplomimit, nivelet e punësimit, ndërkombëtarizimi i universitetit, etj.			
	<i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i>			
	<i>An. 1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i programit të studimit në kuadër të akreditimit kryhet për herë të dytë, në përputhje me kërkesat ligjore. Ndërkohë, vlerësime për cilësinë e ofrimit të tij janë kryer në mënyrë të vazhdueshme nga FE, që në aktivizimin e programit për herë të parë në vitin akademik 2012-2013. Rishikimi periodik i programit dhe përditësimet e tij në elementët e cituar në standardin VI.2, janë pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të tij prej vitesh. Këto procese kryhen në bashkëpunim me NJSBC dhe në përputhje me procedurat, aktet rregullatorë të KUQ dhe rregullores së NJSBC. Vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi.

	<p>Rezultatet e vlerësimit, përfshihen në raportet vjetore të njëjësive kryesore dhe të institucionit.</p> <p><i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>An. 1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC</i></p> <p><i>An. 3_3_Analizë vjetore e Departamentit të Manaxhimit</i></p> <p><i>An 1_4_1_Manuali i Cilësisë së KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Metodat e vlerësimit të cilësisë bazohen në mekanizma kryesore të matjes në bazë të të cilave kryhet vlerësimi i cilësisë të programit të studimit janë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi nga NJSBC në nivel institucional - Monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit të studimit - Vlerësime nga komisione ad-hoc të ngritura nga Dekani i fakultetit në bashkëpunim me NJSBC. Realizim sondazhesh, anketimesh dhe mbledhje informacionesh nga studentët, - Monitorime nga drejtuesit e departamentit <p>Në të gjitha raportet përfshihen rezultatet e protshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat që duhet të ndërmerren për të adresuar mangësitë dhe për të arritur përmirësimin e cilësisë në të gjitha dimensionet e saj.</p> <p><i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare</p>	<p>KUQ për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta si vlerësimet e didaktikës apo metodave të mësimdhënies nga vetë studentët e deri tek vëzhgimet në auditor. Takimet me studentët, takime me këshillin studentor janë proces i vazhdueshëm që realizohet nga Dekani i fakultetit në shumicën e rasteve raportimet e tyre, apo pjesëmarrja e këshillit studentor në mbledhjet e dekanatit, shpesh janë pikënisja e një procesi të caktuar monitorimi /vlerësimi. Një nga procedurat e ndjekura në vitet e fundit në kuadër të përmirësimit të cilësisë (për të gjitha programet e studimit që ofron KUQ) si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimet e provimeve apo detyrave të studentëve, janë realizuar me takime të drejtpërdrejta apo pyetësorë me studentë, nëpërmjet komisioneve ad hoc (shih stand. VII dhe 2), apo duke marrë edhe mendimet dhe sugjerimet e studentëve të diplomuar ALUMNI -KUQ.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 93

si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Disa nga mënyrat e vlerësimit të drejtëpërdrejtë janë:

- Verifikimi i kurrikulës që në momentin e hartimit të saj dhe deri tek ndjekja e zbatimit të saj hap pas hapi.
- Verifikimi i procesit të përvetësimit të njohurive nga studentët, mundësia e të mësuarit dhe koha në dispozicion.
- Vlerësimi i provimeve me objektivitet dhe në mënyrë të tillë që teza të paraqesë standardin e duhur për cilësinë e diplomës së kërkuar.
- Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet verifikimit dhe kontrollit të procesit duke filluar që nga literatura e deri tek metodika e dhënies nga pedagogu.

An. 1_7_4_Pyetësi mbi performancën e pedagogut

An. 1_4_Rregullore e NJSBC

Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program

Tregues i cilësisë së programit të studimit është dhe se si ai u shërben studentëve pas diplomimit, në punësimin e tyre. Zyra e Karrierës dhe KUQ në vijimësi mban kontakte me ALUMNI KUQ.

Tregues tjetër i cilësisë së programit është dhe performanca e studentëve në nivel ndërkombëtar, si në aspektin profesional ashtu dhe në atë akademik. Në aspektin profesional, studentët e diplomuar në programet e KUQ, kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit në shume vende të tjera. Në aspektin akademik, studentë të diplomuar nga FE kanë ndjekur ose ndjekin studime master apo phd në vende të ndryshme, duke përmirësuar dhe implementuar teknika dhe metoda të reja dhe bashkëkohore në fushën prekatëse.

An. 2_13_të dhëna për punësimin e studentëve

An. 2_15_Statistikë mbi diplomimin e studentëve dhe punësimin

An. 1_1_Evidencë statistikë për punësimin e studentëve në profesion

Aneks. 2_13_2 Pyetësi për studentet ALUMNI

Shkalla e përmbushjes së standardit

Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha nivelet e strukturave përbërëse të KUQ janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit dhe insitucionit, kjo bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore që institucioni ka të parashikuar.</p> <p>Synimi kryesor, përcaktuar në këto akte, është gjithpërfshirja e kontribuesve në procesin e mësimdhënies dhe aspekteve të tjera akademike.</p> <p><i>An. 1_1_ Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 1_3_ Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi ” (KUQ)</i></p> <p><i>An. 1_4_ Rregullore e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Konkretisht përgjegjës për ofrimin e programit të studimit MBA është departamenti. Sikundër është përshkruar në standardin VI.3 më lart, të gjithë mekanizmat e parashikuara në kuadër të sigurimit të cilësisë së programit të studimit, janë gjithëpërfshirës.</p> <p>Në aktet rregullative (Rregullore e KUQ dhe të Fakultetit) janë të përcaktuar qartë jo vetëm rolet por dhe përgjegjësitë e çdo njësie/strukture dhe individit të angazhuar në ofrimin e programit të studimit dhe garantimin e cilësisë së tij. Aspekte si:</p> <ul style="list-style-type: none">- Evidentimi dhe ndjekja e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies.- Vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.- Realizimi i studimeve për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti.- Organizimi dhe ndjekja e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi.- Orientimi dhe udhëheqja metodike e procedurave të veprimit për vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete.



	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i performancës së stafit akademik, vlerësime nga studentët për aspekte të ndryshme - Zbatimi i detyrave të lëna nga grupe të jashtme vlerësimi, auditimi dhe hartimi i planit të masave janë disa nga elementët kyç që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, kontrollin e vazhdueshëm të saj gjatë zhvillimit të programit të studimit, që aplikojnë njësitë përgjegjëse sipas fushës së veprimtarisë në FE_KUQ. <p><i>An. 1_1 Statuti i KUQ</i></p> <p><i>An. 1_4_1 Manuali i Cilësisë së KUQ</i></p> <p><i>An. 1_3 Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi” (KUQ)</i></p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit kemi një përfshirje të stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve të programit të studimit. Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë dhe ofrimit të programit të studimit është proces dinamik dhe në zhvillim në Departamentin Shkecape të Administrimit. KUQ ka në filozofinë e vet transparencën dhe informimin në lidhje me proceset që kryhen. Si rregull çdo procedurë që kryhet kalon nëpërmjet njoftimit paraprak dhe më pas kalon në proces zhvillimi. Gjithashtu, në këto procese vazhdimisht përfshihen bashkëpunëtorë, partnerë ose dhe studentë të diplomuar, të cilët ndihen pjesë integrale e çdo procesi me rëndësi në fakultet.</p> <p><i>An. 1_4_1 Manuali i Cilësisë së KUQ</i></p> <p><i>An. 1_3 Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi” (KUQ)</i></p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>An. 3_2 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i></p> <p><i>An. 3_4 Rregullore e programit të studimit të AB-së</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit</p>	<p>KUQ ka një politikë të aktivizimit të aktorëve duke respektuar integritetin e tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi ndaj palëve të përfshira në proces. Kjo politikë e ndjekur nga KUQ, NJSBC dhe fakulteti ka ndikuar në krijimin e një kulture përgjegjshmërie dhe përgjegjësie lidhur me rolin e gjithsecilit në mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 96




dhe studentëve për programin e studimit.	<i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi ” (KUQ)</i> <i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 3_4_Rregullore e programit të studimit të AB-së</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	KUQ bën pjesë aktive të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe bashkëpunëtor të saj të jashtëm apo ekspertë të programit të studimit, që japin mendime me vlerë të shtuar në lidhje me cilësinë. Ekspertët nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, profesorë të fushave ekonomike, angazhimi dhe pjesëmarrja në projekte kombëtare janë elementët që bashkojnë ekspertë dhe pedagogë të jashtëm në këtë proces vlerësimi për intitucionin. <i>An. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit</i> <i>An. 1_19_Të dhënat të plota, të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik të KUQ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni përmes proceseve të hapura dhe të bëra publike (nëpërmjet platformes), fton studentët dhe personelin akademik të njihen me procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht kërkon që ata të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet. Procesi i njohjes me procedurat apo njoftimet periodike, vijohet dhe me publikimin e rezultateve, raporteve nga procese të zhvilluara. Konkretisht, raportet vjetore, vendimet e organeve kolegjiale, raportimet periodike të Rektoratit që lidhen me procesin mësimor dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, janë proces i vazhdueshëm.

	<p>Të gjitha politikat, strategjitë dhe organizimi janë transparente dhe shpërdarja e informacionit bëhet nëpërmjet njësive bazë dhe atyre drejtuese, në takimet që ato zhvillojnë me stafin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i> <i>An. 1_4_1 Raporti vjetor i NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. NJSBC raporton aktivitetin e saj në rektorat dhe tek drejtuesit e njësive duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave dhe rezultateve, për të marrë masa për rregullimin dhe përmirësimin e tyre.</p> <p><i>An. 1_7 Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale e KUQ</i> <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i> <i>An. 1_4_1 Raporti vjetor i NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e publikuara që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, plotësohen më një aspekt mjaft të rëndësishëm sic është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet përkatëse në strukturat apo organet përkatëse, sipas impaktit që kanë këto gjetje. Pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna. Referuar vendimit të fundit të akreditimit institucional rezultojnë që të jenë lëna rekomandime për përmirësim kurrikulash, pjesëmarje/aktivizime në aktivitete kërkimore shkencore, pasurim Fondit të Bibliotekës, rekrutim stafi me grada e tituj shkencorë dhe përmirësim i vazhdueshëm i tyre, si dhe roli më proaktiv i NJSBC.</p> <p><i>An. 1_4_1 Raporti vjetor i NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë,</p>	<p>Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili kërkon përveç mekanizmave të konsoliduar edhe ndërgjegjësim të personelit akademik, administrativ dhe të studentëve. Proceset e vlerësimit në kuadër të akreditimit që janë zhvilluar në KUQ, kanë patur impakt në ndërgjegjësimin e të gjithë strukturave, personelit</p>

në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	akademik dhe tek studentet, për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.			
	<i>An. 3_1_Plani i punës dhe realizimi i rekomandimeve të akreditimit të MSHAB</i>			
	<i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i>			
	<i>An. 1_4_1_Raporti vjetor i NJSBC</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për të rritur këtë impakt dhe kulturën e vetë ndërgjegjësimin, NJSBC vazhdimisht organizon takime me strukturat e rektoratit dhe fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijimësi të saj.			
	Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
	<i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi ” (KUQ)</i>			
	<i>An. 1_29_Veprimtaria e shoqatave studentore në KUQ</i>			
	<i>An. 1_20_Veprimtari e shoqatave të studenteve në KUQ</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Administrim Biznesi” të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Qiriazi”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Në këtë program studimi ka disa titullarë lëndësh me kualitet të lartë akademik dhe aplikativ.
2. Ka rishikimet e nevojshme të disa prej syllabuseve për ti përafuar ato me realitetin dhe zhvillimet në administrimin e biznesit në Shqipëri.
3. Ka prezencë të evidentuar mediatikisht në forume, konferenca dhe takime të cilat i mundësojnë stafit akademik të këtij programi të kenë kontakte, të marrin përgjigje apo shkëmbejnë ide me ekspertë të fushës vendas apo të huaj.
4. Vendodhja e KUQ është një pikë e fortë për shkak të afërsisë me institucionet kryesore në vend dhe mbulohet lehtësisht nga transporti publik.
5. Shumë aktiv në lidhjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve konkrete me IAL të tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.

Pika të dobta:

1. Personeli akademik kryen edhe detyra administrative, kjo mund të pengojë këta të fundit në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj procesit mësimor e kërkimit shkencor. **(Standardi IV.2)**
2. Hapësira e ofruar nga biblioteka është relativisht e limituar. **(Standardi IV.4)**
3. Mungesë të mbështetjes financiare për kërkimin shkencor të studentëve të këtij programi studimi, të cilët mund të kenë interesa për thellimin e kërkimit të tyre shkencor. **(Standardi V.7)**
4. Nuk ka mundësuar ende përfshirjen e studentëve, alumni, punëdhënës apo ekspertë të jashtëm të fushës etj, në Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. **(Standardi VI.1)**
5. Nuk ka evidencë që IAL të ketë siguruar transparencë për publikimin në faqen web të KUQ të Raporteve për analizat e rezultateve të pyetësorëve nga anketimi i studentëve. **(Standardi VI.5)**

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të angazhohet në rritjen e mobiliteteve Erasmus + si për studentët, ashtu dhe për stafet akademike.
2. Është e nevojshme që të bëhen transparente procedurat e përzgjedhjes së projekteve fituese të fondit që alokon vetë institucioni (Fondi i Kërkimit) si dhe nevojitet një pjesëmarrje më e gjerë në projekte komëbtare dhe ndërkombëtare.

Adresa: “Rruga e Durrësit” , Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 100

3. Institucioni duhet të marrë masat për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. Fondi i Bibliotekës të pasurohet me literaturë shqiptare e të huaj të 5 viteve të fundit.
4. Të verifikohen dhe sigurohet që dëshmia e gjuhës së huaj (të një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht) të merret që në procesin e regjistrimit të studentëve, në përputhje me kuadrin ligjor respektiv në Arsimin e Lartë.
5. Rekomandojmë që institucioni të marrë masat për disponimin e një sistemi elektronik të menaxhimit, nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, që nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.
6. Institucioni duhet të mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të studentëve.
7. Do ishte mirë që FE-KUQ të ftojë edhe më shumë lektorë nga institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe bota e biznesit.
8. Ndarja e ngarkesës akademike dhe asaj administrative.
9. IAL të kujdeset për publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.
10. IAL të marrë menjëherë masat për plotësimin e rekomandimit të Bordit të ASCAL për zgjerimin e ambienteve në funksion të programeve të studimit, të hapura dhe akredituara pranë KUQ.



Strengths and Affirmations:


1. In this study program there are several academic staff with high academic and applied qualitative experiences.
2. There are necessary revisions of some of the syllabuses to align them with reality and developments in the business administration in Albania.
3. There is media evidenced presence in forums, conferences and meetings which enable the academic staff of this program to have contacts, receive answers or exchange ideas with local or foreign experts in the field.
4. The location of KUQ is a strong point due to its closeness to the main public institutions in the country and is easily covered by public transport.
5. Very active in signing agreements and collaborations with other homologous HEIs inside and outside the country.

Weak points:

1. Academic personnel perform administrative tasks as well. This may prevent them from fulfilling their obligations towards the teaching process and scientific research. **(Standard IV.2)**
2. The space offered by the library is relatively limited. **(Standard IV.4)**
3. Lack of financial support for scientific research of students of this program who might have interest in deepening scientific research. **(Standard V.7)**
5. HEI has not yet enabled the inclusion of students, alumni, employers or external experts of this field, in the Internal Quality Assurance System. **(Standard VI.1)**
6. There is no evidence that the HEI has ensured transparency for the publication on the KUQ website of the Reports for the analysis of the results of the questionnaires from the student surveys. **(Standard VI.5)**

Recommendations:

1. The Institution should apply and be more active in international projects like Erasmus + in order to increase mobilities for students and academic staff.
2. It is necessary to make transparent the selected procedures of the winning projects of the fund allocated by the institution itself (Research Fund) and a wider participation in national and international projects is needed.
3. The institution should take measures to increase the number of library items, update the existing fund in support of the program. The library should be enriched with Albanian and foreign literature of the last 5 years.
4. It is important to verify and ensure that proof of the foreign language (of one of the five languages of the European Union: English, French, German, Spanish, Italian) is obtained in



the phase of student registration process, in accordance with the respective legal framework in the Higher Education.

5. We recommend that the institution should take the right measures to have an electronic management system soon, through which it manages all information related to students and their activity from registration to graduation in the respective study program.


6. The institution should support more the publication of students' scientific research work in international scientific journals.

7. It would be good for FE-KUQ to invite even more guest lecturers/speakers from international institutions of higher education and business world.

8. Separation of academic and administrative workload.

9. The HEI should take care of publishing the results of the evaluations of the study program, respecting academic freedom and ethics, as well as the legislation on personal data.

10. The HEI should immediately take measures to fulfill the recommendation of the ASCAL Board for the expansion of the facilities in function of the study programs opened and accredited at the KUQ.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X